

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6113
E hënë, 13 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Me bartje të maskës fillon viti i ri shkollor

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ | FAQE 4-5

AAK-ja E KA NDARË MENDJEN E VET, RAMUSH HARADINAJ PËR PRESIDENT

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se ky subjekt politik e ka ndarë mendjen e vet sa i përket çështjes së presidentit të vendit. Nitaj ka thënë se AAK-ja e ka vlerësuar Ramush Haradinajn si personin më të përshtatshëm dhe më unikues për president në këtë kohë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Nitaj ka pohuar se "tash mbetet t'i bindim të tjerët për mbështetje se propozimi është serioz dhe i duhuri". Ai ka thënë se deri më tash në Qeverinë e Kosovës ka pasur një klimë konstruktive bashkëpunimi. Nitaj ka thënë se partnerët e koalicionit qeverisës kanë pasur disa dallime në qëndrime vetëm sa i përket mënyrës se si ka filluar të organizohet e të rrjedhë procesi i dialogut me Serbinë



OPINION

NË KUJTIM TË SULEJMAN
GASHIT, GAZETARIT DHE
MISIONARIT TË SHTETIT TË
KOSOVËS NË AMERIKË F. 11

Shkruan:
Nuhi BYTYÇI



AKTUALE

NDËRRON JETË MJEKU DHE
POLITIKANI SABIT BROKAJ F. 2

EDHE SHTATË TË VDEKUR DHE
71 RASTE TË REJA ME COVID NË
KOSOVË F. 5

MBI 100 PERSONA ME KANCER,
TË SËMURË EDHE ME COVID-19 F. 10

EKONOMI



MUNGESA E RRYMËS LARGON
INVESTITORËT E HUAJ NGA
KOSOVA F. 8-9

TURIZMI NË SHOIPËRI,
91 MILIONË EURO TË ARDHURA
PËR GJASHTË MUJ F. 8

SPORT

ADEMI: 29 VJET MË PARË
NISI RRUÇËTIMI I FUTBOLLIT
TË PAVARUR F. 16



Opozita thotë se 100 ditët e qeverisë Hoti janë të dështuara



Opozita e ka vlerësuar të dështuar 100-ditëshin e parë të qeverisë Hoti. Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë fajësuar qeverinë për keqmenaxhim të pandemisë dhe për marrëveshjen e Uashingtonit. Për partinë e Albin Kurit, gjatë kësaj periudhe kohore

kishte vetëm nënshtrim dhe dështim, kurse për partinë e Kadri Veselit kishte dështim në qeverisjen e brendshme dhe të jashtme. Kryeministri Avdullah Hoti ka mohuar këto kritika. Ai ka thënë se brenda 100 ditëve e ktheu Kosovën aty ku e kishte vendin | FAQE 3

Deputetja
Blerta Deliu
në çdo cep
të Kosovës
promovon
fushatën
inkurajuese
'Gratë për gratë'

FAQE 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net


INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ndërron jetë mjeku dhe politikani Sabit Brokaj

TIRANË, 13 SHTATOR - Ka ndër-ruar jetë në moshën 78-vjeçare mjeku dhe politikani Sabit Brokaj. Pas një karriere të gjatë në shëndetësi, madje dhe si një prej mjekëve të Enver Hoxhës, Brokaj hyri në politikë pas rënies së diktaturës, nën siglën e Partisë Socialiste.

Ishte ministër i Shëndetësisë në vitin 1991 dhe ministër i Mbrojtjes në vitin 1997. Kardiologu Sabit Brokaj ka qenë deputet i parlamentit shqiptar për disa legjislatura. Pas krijimit të LSI-së ai u rendit në krah të Ilir Metës si nënkryetar i partisë. Më pas, në vitin 2015 u rikthye në

Partinë Socialiste si pjesë e Këshillit të të Urtëve. Këto ishin dhe angazhimet e tij të fundit politike, pasi prej vitesh i ishte rikthyer profesionit të mjekut. Për vdekjen e Sabit Brokaj kanë reaguar udhëheqësit më të lartë të Shqipërisë dhe ata të Kosovës.



ShBA-ja vazhdon të përballet me zjarre

OREGON, 13 SHTATOR - Zjarre të mëdha që kanë shpërthyer në perëndim të Shteteve të Bashkuara kanë mbuluar zona të mëdha të Kalifornisë, Oregonit dhe Uashingtonit me re tymi, që kanë nxitur evakuimin e banorëve nga frika se mund të ketë numër të madh të viktimave.

Gjysmë milioni njerëz në Oregon më 12 shtator janë urdhëruar që të largohen nga shtëpitë e tyre, që t'u ikin zjarreve dhe ajrit të ndotur. Ndërkaq, personat që kanë vendosur të mos largohen, janë



udhëzuar që të qëndrojnë të mbyllur në shtëpi dhe të mbyllin

dritaret. Shërbimi Kombëtar i Motit ka

publikuar fotografi satelitore, ku shfaqet një re masive e tymi, që gjendet përgjatë Bregut Perëndimor e që arrin deri në Oqeanin Paqësor.

Zjarret vazhduan të përhapen më 12 shtator, por me një ritëm më të ngadaltë sesa në fillim të javës.

Në Kaliforni aktualisht janë 28 zjarre të mëdha aktive që kanë djegur mbi 2 milionë hektarë tokë.

Deri më tani 20 persona kanë vdekur në Kaliforni që prej se zjarret shpërthyen në mes të muajit gusht dhe më shumë se 4

000 shtëpi janë djegur.

Në Oregon të paktën gjashtë persona kanë vdekur dhe mijëra shtëpi janë djegur. Disa qytete të vogla janë shkatërruar plotësisht. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, do ta vizitojë Kaliforninë më 14 shtator për t'i parë nga afër dëmet e shkaktuara nga zjarret, njoftoi Shtëpia e Bardhë. Kandidati demokrat për president, Joe Biden dhe guvernatorët e Kalifornisë, Oregonit dhe Uashingtonit, kanë thënë se zjarret janë pasojë e ngrohjes globale.

Greçia mirëpret tërheqjen e anijes kërkimore turke

ATHINË, 13 SHTATOR - Kryeministri i Greqisë, Kyriakos Mitsotakis, ka thënë të dielën se kthimi për në Turqi i anijes kërkimore turke "Oruc Reis" është hapi i parë pozitiv në shtendosjen e tensioneve në mes të dy vendeve.

Anija kërkimore "Oruc Reis" është rikthyer në Antali.

Tensionet mes Greqisë dhe Turqisë u rritën së fundmi lidhur me pretendimet e të dyja palëve për burimet

natyrale Mesdheun Lindor. "Kthimi i 'Oruc Reis' është hapi i parë pozitiv. Shpresoj që të ketë vazhdimësi në këtë aspekt. Ne duam të bisedojmë me Turqinë, por në një klimë ku nuk do të ketë provokime", u tha në konferencën e gazetarëve në Selanik, kryeministri grek, Mitsotakis. Ai ka theksuar se dialogu është mënyra e vetme për t'i tejkaluar problemet që kanë dy shtetet sa i përket përcaktimit të kufirit ujor. "Hapi i parë (nga

Turqia) do ta përmirësojë situatën sa iu përket marrëdhënieve tona dypalëshe", tha ai.

Tensionet mes Athinës dhe Ankarasë u përkeqësuan, pasi Turqia rinisi kërkimet për gaz dhe naftë jashtë ishullit grek Kastellorizo.

Turqia dërgoi anijen kërkimore "Oruc Reis", shoqëruar nga anijet ushtarake, duke bërë që Greçia t'i dërgonte anijet e veta në zonë për ta monitoruar punën e Turqisë.



"AstraZeneca" dhe Universiteti i Oksfordit do t'i rinisin testimet për vaksinën kundër Covid-19

LONDËR, 13 SHTATOR - Kompania farmaceutike "AstraZeneca" dhe Universiteti i Oksfordit do t'i rinisin testimet për vaksinën kundër sëmundjes Covid-19 që shkakton koronavirusi i ri. Më 8 shtator testimet për këtë vaksinë u pezulluan pasi një vullnetarit nga Mbretëria e Bashkuar iu përkeqësua gjendja shëndetësore, raporton BBC. AstraZeneca më pas ka njoftuar se do të hetojë nëse përkeqësimi i shëndetit të vullnetarit ishte efekt anësor i vaksinës që kjo kompani po zhvillon.

Por, të shtunën, Universiteti i Oksfordit tha se e konsideron të sigurt vazhdimin e testimet



të vaksinës potenciale kundër Covid-19.

Ky universitet tha se është e "pritshme" që disa

pjesëmarrës në studimet që po kryhen për vaksinën "mund të sëmuren".

Autoritetet britanike thanë se

testimet do të vazhdojnë dhe do të ndiqen rekomandimet e një komiteti të pavarur për sigurinë, që vepron në kuadër të Agjencisë Rregullative të Barnave dhe Produkteve Shëndetësore të Mbretërisë së Bashkuar.

Ndonëse në Mbretërinë e Bashkuar sëmundjet e pacientëve janë konfidenciale dhe nuk publikohen, "New York Times" ka raportuar se një vullnetar nga Mbretëria e Bashkuar u diagnostikua me një sinkron inflamator që prek palcën kurrizore dhe që mund të shkaktohet nga infeksionet virale.

Vaksina, që po zhvillohet nga "AstraZeneca" dhe Universiteti

i Oksfordit në Britani, është një prej projekteve më premtuese në luftën kundër sëmundjes Covid-19.

"AstraZeneca" është një prej tri kompanive që kanë arritur në fazën e tretë të testeve të vaksinave për koronavirus në Shtetet e Bashkuara meqë atje janë siguruar mijëra vullnetarë për marrje të vaksinës.

Dy vaksinat e tjera po zhvillohen nga kompanitë "Pfizer" dhe "Moderna". Organizata Botërore e Shëndetësisë thotë se aktualisht në botë janë duke u testuar rreth 180 vakcina potenciale kundër koronavirusit.

Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ia numërojnë dështimet qeverisë Hoti

Opozita thotë se 100 ditët e qeverisë Hoti janë të dështuara



Opozita e ka vlerësuar të dështuar 100-ditëshin e parë të qeverisë Hoti. Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë fajësuar qeverinë për keqmenaxhim të pandemisë dhe për marrëveshjen e Uashingtonit. Për partinë e Albin Kurit, gjatë kësaj periudhe kohore kishte vetëm nënshtrim dhe dështim, kurse për partinë e Kadri Veselit kishte dështim në qeverisjen e brendshme dhe të jashtme. Kryeministri Avdullah Hoti ka mohuar këto kritika, duke thënë se brenda 100 ditëve e ktheu Kosovën aty ku e kishte vendin

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Dy subjektet opozitare kanë akuzuar qeverinë Hoti për dështim në 100 ditët e para të qeverisë së saj. Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë kritikuar qeverinë për keqmenaxhim të pandemisë gjatë kësaj kohe dhe për marrëveshjen e Uashingtonit e cila është nënshkruar më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë. LV-ja përmes një reagimi në faqen zyrtare të vet në "Facebook" ka vlerësuar se gjatë kësaj periudhe kohore kjo qeveri iu ka hapur Serbisë, ka menaxhuar në mënyrë katastrofale pandeminë dhe ka rifilluar kapjen e bordeve të ndërmarrjeve publike. "Nga qeverisja e mirë legjitime që luftonte krimin e korrupsionin, menaxhonte mirë me

pandeminë dhe e nisi çkapjen e shtetit u kontrabandua një qeverisje jolegjitime e paligjshme që iu hap Serbisë, menaxhoi në mënyrë katastrofale pandeminë dhe rifilloi kapjen e bordeve dhe ndërmarrjeve publike ashtu siç di vetëm klubi i politikanëve të stërvjetëruar. 100 ditë nënshtrim, dështim, keqmenaxhim, regres, dorëzim. 100 ditë jolegjitime dhe të paligjshme", është thënë në reagimin e LV-së. Edhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e ka konsideruar të dështuar në qeverisjen e brendshme dhe politikën e jashtme, 100-ditëshin e punës së qeverisë të udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti.

Sipas kësaj partie, qeveria Hoti në 100 ditët e punës e futi Kosovën në listën e zezë për keqmenaxhimin e pandemisë dhe firmosi bashkëpronësinë e

Ujmanit me Serbinë. "Kjo periudhë e qeverisjes u karakterizua me dështim në menaxhimin e pandemisë, ku Kosova shënoi ndër rastet më larta në botë sa i përket numrit të të infektuarve dhe të vdekurve për kokë banori. Kosova u fut në listën e zezë të udhëtimeve të qytetarëve tanë nga shumica e vendeve të rajonit dhe ato evropiane. Krahas kësaj, qeveria Hoti dështoi t'i dalë në ndihmë ekonomisë dhe qytetarëve të vendit duke mos përmbushur as për së afërmi premtimet për rimëkëmbje ekonomike. Mijëra punëtorë po rrezikojnë vendet e tyre të punës, ndërsa qindra biznese janë afër kolapsit si pasojë e krizës së shkaktuar nga pandemia dhe paaftësisë së kësaj qeverie. Qytetarët e Kosovës po varfërohen çdo ditë e më shumë", ka vlerësuar PDK-së përmes një komunikate për

medie. Për shkak të përplasjeve dhe kërcënimeve të vazhdueshme brenda partnerëve të koalicionit, sipas PDK-së, kjo qeveri e ka besimin shumë të ulët dhe qytetarët po zhgënjehen çdo ditë. "Dështimi në qeverisjen e brendshme u karakterizua me dështimin në politikën e jashtme javën që shkoi, ku delegacioni i Kosovës i udhëhequr nga kryeministri Hoti, humbi shansin historik për arritjen e një marrëveshje me njohjen e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë në Uashington. Nga përplasjet e brendshme fisnore të anëtarëve të delegacionit u pranua të ndahet pronësia për Liqenin e Ujmanit me Serbinë, u lejua të negociohet për pasuritë kombëtare të Kosovës dhe u rrezikuan interesat strategjike të vendit", ka vlerësuar PDK-ja, duke shtuar se qeveria Hoti dështoi t'i përmbushë pritjet e qytetarëve për arritjen e një marrëveshje historike finale duke rrëshqitur gradualisht drejt temave teknike me Serbinë.

Më tej, kjo parti ka deklaruar se kjo qeveri është e dobët, aspak transparente dhe pa kurrfarë mbështetje legjitime qytetare për ta qeverisur Kosovën. Këto kritika i ka mohuar i pari i

qeverisë, Avdullah Hoti. Kryeministri ka bërë me dije se brenda 100 ditëve kjo qeveri e ka kthyer Kosovën aty ku e ka vendin. "Nuk ka më izolim të Kosovës. Për 100 ditët e kemi kthyer Kosovën aty ku e ka vendin: në Shtëpinë e Bardhë, në kryeqytetin e BE-së në Bruksel, në selinë e NATO-s, në Paris dhe së shpejti edhe në qendrat e tjera. Pas një devijimi disavjeçar, e kemi kthyer Kosovën prapë në rrugën e integritit euro-atlantik", ka shkruar Hoti në profilin e vet në "Facebook".

Sipas shefit të ekzekutivit, kjo punë është arritur pa shpenzuar miliona për lobime të ndryshme. "E gjithë kjo është arritur pa shpenzuar miliona për lobim, por me përkrahjen e miqve, duke i bindur se kjo qeveri është serioze karshi zotimeve të veta, me vendimmarrje bazuar në ligje dhe kushtetutë, e jo interesa parapolitike", ka shkruar Hoti. Pas rrëzimit të qeverisë së Albin Kurtit me mocion mosbesimi në Kuvend, LDK-ja mori përgjegjësinë për ta formuar qeverinë e re me partnerë qeverisës AAK-në, Nismën dhe minoritetet.

Qeveria e udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti është votuar në Kuvendin e Kosovës më 3 qershor.



FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ

AAK-JA E KA NDARË MENDJEN E VET, RAMUSH HARADINAJ PËR PRESIDENT

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se ky subjekt politik e ka ndarë mendjen e vet sa i përket çështjes së presidentit të vendit. Nitaj ka thënë se AAK-ja e ka vlerësuar Ramush Haradinajn si personin më të përshtatshëm dhe më unifikues për president në këtë kohë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Nitaj ka pohuar se tash mbetet t'i bindim të tjerët për mbështetje se propozimi është serioz dhe i duhuri. Ai ka thënë se deri më tash në Qeverinë e Kosovës ka pasur një klimë konstruktive bashkëpunimi. Nitaj ka thënë se partnerët e koalicionit qeverisës kanë pasur disa dallime në qëndrime vetëm sa i përket mënyrës se si ka filluar të organizohet e të rrjedhë procesi i dialogut me Serbinë

Kosovës dhe Serbisë. "Është një marrëveshje e mirë sepse është arritur në Shtëpinë e Bardhë. Është një marrëveshje ku Kosovës i hapet një perspektivë ekonomike. Natyrisht ajo ka edhe një peshë politike sepse ka prodhuar një njohje tejet të rëndësishme për Kosovën nga Izraeli dhe sikur e ka rikthyer Kosovën në vëmendjen ndërkombëtare", është shprehur ai.

Nitaj ka dhënë një përgjigje edhe sa i përket çështjes së Ujmanit, ku pati deklarime sa i përket kësaj pike mes LDK-së dhe AAK-së. Ai thotë se këtë çështje e konsideron të tejkaluar tashmë. "Secili e ka pasur të vërtetën e tij dhe një ditë do të merret vesh përfundimisht se

kush e ka ndërtuar narrativën e së vërtetës me hile. Opinioni publik në Kosovë i janë shpërfaqur dy versione të ndryshme dhe e vërteta absolute, ndoshta do të mund të merret vesh, nëse ndonjë ditë publikohen farë kabllogramesh, por e thashë kjo tashmë s'ka rëndësi", ka deklaruar Nitaj. Këtë "përplasje" Nitaj nuk e sheh si prishje të raporteve të LDK-së dhe AAK-së. "Unë dua të besoj në arsyen, racionalitetin dhe përgjegjësinë e liderëve të këtij koalicioni. Mospajtimet janë kollaj të kapërcyeshme dhe nëse s'ka motive të tjera, nuk shoh se kjo mund ta rrezikojë koalicionin", ka thënë Nitaj. Në këtë intervistë, nënkryetari i AAK-së ka folur edhe për

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se

deri më tash në Qeverinë e Kosovës ka pasur një klimë konstruktive bashkëpunimi. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Nitaj ka thënë se partnerët e koalicionit qeverisës kanë pasur disa dallime në

qëndrime vetëm sa i përket mënyrës se si ka filluar të organizohet e të rrjedhë procesi i dialogut me Serbinë.

Nitaj ka dhënë opinion edhe sa i përket marrëveshjes së arritur në Uashington në mes të



ishite aspak e pazakontë sikur të mos vërehej edhe ana pozitive e mospajtimeve e, pse jo, edhe e kundërshtive brenda koalicionit, nëse për synim kanë gjetjen e zgjidhjeve më të mirë. Në qeveritë demokratike ka edhe zëra ndryshe, edhe votë kundër, edhe përplasje argumentesh, edhe mospajtime. Në Qeverinë e Kosovës, të paktën deri më tash, ka pasur një klimë konstruktive bashkëpunimi. Kemi pasur disa dallime në qëndrime vetëm për sa i përket mënyrës se si ka filluar të organizohet e të rrjedhë procesi i dialogut. Por, edhe këto aspekte po diskutohen hapur e pa dorëza dhe kjo është pozitive, vlerësoj unë.

“Epoka e re”: A është i nevojshëm zgjerimi i këtij koalicioni, sepse kohët e fundit është folur për mundësinë e inkudrimit të PDK-së në këtë koalicion?

Nitaj: Ne kemi marrëveshje koalicioni me LDK-në. Kjo e fundit e ka marrë mandatin për krijimin e qeverisë. Ajo duhet ta vlerësojë nëse është i nevojshëm zgjerimi i koalicionit ose jo, e jo Aleanca. Tani, nëse ndodh zgjerimi i koalicionit, me këdo qoftë tjetër, dhe nëse kjo nuk nënkupton shkeljen e parimeve tona mbi të cilat e kemi ndërtuar koalicionin, ne nuk do të kishim asnjë arsye për ta kundërshtuar.

“Epoka e re”: Marrëveshja e Uashingtonit ka “përplasur” LDK-në dhe AAK-në sa i përket çështjes së Liqenit të Ujmanit, ku kemi dy deklarata të ndryshme. Njëra palë thotë se pati ndërhyrje në marrëveshje (AAK-ja) e tjetra palë (LDK-ja) thotë se marrëveshja nuk është prekur në këtë pikë.

Nitaj: Unë këtë çështje e konsideroj të tejkaluar tashmë. Secili e ka pasur të vërtetën e tij dhe një ditë do të merret vesh përfundimisht se kush e ka ndërtuar narrativën e së vërtetës me hile. Opinioni publik në Kosovë i janë shpërfaqur dy versione të ndryshme dhe e vërteta absolute ndoshta do të mund të merret vesh, nëse ndonjë ditë publikohen farë kabllogramesh, por e thashë kjo tashmë s’ka rëndësi. E rëndësishme është që Kosova të mos gjendet edhe një herë tjetër në një situatë të ngjashme, ku për çështje jetike flasim në orët e fundit, sepse pasojat për vendin mund të jenë të pariparueshme. Jemi tepër të brishtë për të mos u pajtuar ndër vete.

“Epoka e re”: Këto “përplasje” LDK - AAK a mund ta rrezikojnë koalicionin qeverisës?

Nitaj: Unë dua të besoj në arsyen, racionalitetin dhe përgjegjësinë e liderëve të këtij koalicioni. Mospajtimet janë

kollaj të kapërcyeshme dhe nëse s’ka motive të tjera, nuk shoh se kjo mund ta rrezikojë koalicionin. Më ka ra këto ditë të dëgjoj lloj-lloj analizash e opinionesh, për njëfarë nevojë të Aleancës për protagonizëm në procesin e dialogut. Unë ju garantoj se është e kundërta. Aleanca edhe vetë kur e ka drejtuar qeverinë, nuk ka vrapuar pas tryezave të dialogut. Ajo që kërkojmë ne është që gjithçka të jetë e koordinuar, paraprakisht e diskutuar, e harmonizuar dhe bashkërisht e negociuar. Ne jemi partnerë në këtë qeveri dhe është krejt e natyrshme të jemi pjesë, edhe e punës, por edhe e përgjegjësisë në këtë proces, që është më i rëndësishmi që prej shpalljes së pavarësisë. Unë po shpresoj ta shoh edhe përfshirjen e të tjerëve që nuk janë pjesë e qeverisë në dialog.

“Epoka e re”: Cili është opinioni

juaj për marrëveshjen e Uashingtonit?

Nitaj: Është një marrëveshje e mirë sepse është arritur në Shtëpinë e Bardhë. Është një marrëveshje ku Kosovës i hapet një perspektivë ekonomike. Natyrisht ajo ka edhe një peshë politike sepse ka prodhuar një njohje tejet të rëndësishme për Kosovën nga Izraeli dhe sikur e ka rikthyer Kosovën në vëmendjen ndërkombëtare. Nuk është krejt sa kemi pritur por, sidoqoftë, ne në Aleancë kemi besuar se në momentin kur pala serbe ka kërkuar heqjen e pikës për njohje të ndërsjellë, delegacioni i Kosovës në Uashington ka mundur të kishte kërkuar, pa asnjë hezitim, heqjen e pikës për Ujmanin, e cila, megjithëse siç është përpiluar në fund, nuk e paragjykon rezultatin përfundimtar, prapë mbetet me ilet.

“Epoka e re”: Si e sheh AAK-ja

procesin e zgjedhjes së presidentit, ku lideri juaj është propozuar për president. Koalicioni dihet se nuk i ka votat e mjaftueshme për postin e presidentit pa marrë mbështetje edhe nga dy partitë opozitare?

Nitaj: Aleanca e ka ndarë mendjen e vet. E ka vlerësuar Ramush Haradinajn si personin më të përshtatshëm dhe më unifikues për president në këtë kohë. Tash mbetet t’i bindim të tjerët për mbështetje, se propozimi është serioz dhe i duhuri. Propozimi nuk është bërë sot për sot, se po shoh plot njerëz të flasin se propozimi qenka i parakohshëm. Ne jemi në politikë dhe e kuptojmë se Kosova ndër temat e radhës do ta ketë zgjedhjen e presidentit. Në rastin më të mirë Kosova për pesë muaj e pak duhet ta ketë zgjedhur presidentin e ri dhe edhe në një rrjedhë normale, propozimi nuk është e parakohshëm!

Edhe shtatë të vdekur dhe 71 raste të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se për 24 orët e fundit kanë vdekur shtatë pacientë dhe ka konfirmuar edhe 71 raste të reja me Covid-19. Sipas IKShPK-së, gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 163 pacientë

PRISHTINË, 13 SHTATOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë kanë vdekur shtatë pacientë, të cilët ishin të infektuar me Covid-19. Në njoftimin për media, IKShPK-ja ka treguar se gjatë kësaj periudhe kohore janë regjistruar 71 raste të reja me Covid-19. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 612 mostra të

marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 71 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 7 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 14 637 raste nga 57 851 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 596 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 163 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 11.435 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2.606”, është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Sipas këtij njoftimi, rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 13 raste, komuna Ferizaj 7 raste, komuna Pejë 5 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste, komuna Gjakovë 4 raste, komuna Podujevë 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Rahovec 4 raste, komuna Viti 4 raste, komuna Gjilan 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Vushtrri 3 raste, komuna Dragash 2 raste, komuna Mitrovicë 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas, Hani i Elezit, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Shtime dhe Suharekë.



“Epoka e re”: Z. Nitaj, cili është vlerësimi juaj si nënkryetar i AAK-së për këtë koalicion qeverisës?

Nitaj: E kam vënë re tash e sa kohë një interesim të jashtëzakonshëm të politikës e të medias, për të parë nëse po krisë koalicioni. Një pjesë u lë përshtypje e u interesojnë vetëm mospajtimet e kundërshtimet. Kjo nuk do të

Mbi 100 persona me kancer, të sëmurë edhe me Covid-19

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Në Kosovë, rreth 120 pacientë të cilët vuajnë nga kanceri, janë prekur edhe me Covid-19, sëmundje që e shkakton koronavirusi. Megjithatë, asnjë rast nuk ka përfunduar me vdekje.

Adelina (emri i vërtetë i së cilës është i njohur për redaksinë) është njëra nga ta, e cila, krahas kancerit në gjë që e ka diagnostikuar në muajin janar të këtij viti, në muajin korrik është infektuar edhe me koronavirus.

Ajo e ka vazhduar trajtimin me kimioterapi, kurse e ka kaluar edhe koronavirusin. "Unë jam operuar nga kanceri në gjë, meqë u diagnostikova me këtë sëmundje. Kam filluar kimioterapinë, e që kam pasur pak vështirësi, normalisht. Por, në muajin korrik filluan disa simptoma, e që unë mendoja se janë prej kimioterapisë. Por jo, dola Covid pozitiv", ka rrëfyer Adelina për "Radion Evropa e Lirë". "Pas konsultave me doktorin tim që më trajtonte për sëmundjen malinje. Ai më tregoi se çka të përdor dhe ma ka përcjellë gjendjen. Në përgjithësi kam qenë mirë, por shumë e lodhur. Kam pushuar shumë dhe kështu e kam kaluar pa ndonjë telashe, duke e vazhduar edhe terapinë për kancerin", ka treguar ajo.

Mikael Sekeres, mjek specialist

për leukeminë akute në Shtetet e Bashkuara, në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë", ka thënë se personat e prekur me kancer nuk janë në rrezik më të madh nga kapja e virusit, por janë në rrezik më të madh për t'u sëmurë rëndë nëse e marrin virusin. Ai ka veçuar sidomos pacientët që e kanë sistemin imunitar të prekur nga kanceri ose nga trajtimi i kancerit për shembull, pacientët me leukemi ose pacientët me kancer në mushkëri, frymëmarrja e të cilëve mund të jetë e rënduar.

Në Kosovë të hospitalizuar në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare kanë qenë vetëm pesë persona, të cilët kanë pasur sëmundje malinje dhe që kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Të tjerët sëmundjen Covid-19 e kanë kaluar me terapi mbështetëse, krahas terapisë për sëmundjen e kancerit, me të cilën kanë qenë duke u trajtuar.

Infektologu Sali Ahmeti bëri të ditur se pacientët që kanë pasur sëmundje malinje, njëkohësisht janë trajtuar edhe për kancer, edhe për Covid-19. "Sa i përket rasteve kancerogjene, të hospitalizuara kanë qenë gjithsej pesë raste me forma të rënda kancerogjene, si me prekje të mushkërive, leukemi, por që e kanë kaluar sëmundjen pa pasoja. Sa i përket Covid-19, kanë arritur shërim të plotë pas



një ecurie të zakonshme të sëmundjes. Ne kemi përdorur protokoll të njëjtë me të sëmurët e tjerë. Por, këta persona janë me imunitet më të ulët, e që kemi pasur terapi mbështetëse pak më të forcuar, e cila ndikon në rritjen e imunitetit të tyre", ka thënë Ahmeti.

Në Institutin Onkologjik të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës gjatë periudhës janar-korrik të këtij viti janë diagnostikuar 810 raste të reja me kancer.

Ilir Kurtishi, drejtor i këtij Instituti, i tha "Radios Evropa e Lirë" se ka rënie të numrit të të

prekurve me sëmundje malinje, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ai shtoi se në bazë të të dhënave janë 15 për qind më pak të prekur gjatë këtij viti. Ndërkohë, nga muaji mars, kur u paraqitën rastet e para me koronavirus në Kosovë, e deri në muajin maj, kanë qenë vetëm dy persona, të cilët vuanin nga kanceri, të prekur me Covid-19.

Më pas, siç tha Kurtishi, ka filluar të rritet numri i të infektuarve, e që totali tashmë ka arritur në rreth 120. "Të gjithë janë mirë me shëndet dhe asnjë nuk ka përfunduar me fatalitet. Të gjithë kanë vazhduar

trajtimin e tyre për sëmundjen e kancerit pa ndonjë problem. Ndërkaq, sa iu përket sëmundjeve malinje në Kosovë, kanceri i gjirit prin te femrat, derisa kanceri i mushkërive te meshkujt. Incidenca e vdekjeve nga sëmundjet e kancerit është rreth 10 për qind", ka deklaruar Kurtishi.

Në Kosovë numri i përgjithshëm i të prekurve me koronavirus ka arritur në 14 566. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik njoftoi të shtunën se brenda 24 orëve të kaluara kanë vdekur tre pacientë me koronavirus, ndërsa janë konfirmuar 70 raste të reja pozitive.

Deputetja Blerta Deliu në çdo cep të Kosovës promovon fushatën inkurajuese 'Gratë për gratë'

PRISHTINË, 13 SHTATOR (ER) - Kampanja e PDK-së "Gratë për gratë", e udhëhequr nga deputetja Blerta Deliu, ka nisur një fushatë inkurajuese për gratë, në mënyrë që ato ta ndjekin të drejtën e tyre për mundësi të barabarta dhe marrje të përgjegjësive në vendimmarrje.

Gjatë vizitave nëpër komuna, deputetja Deliu, e cila udhëheq Departamentin për Politika Gjimore brenda PDK-së, ka thënë se i janë përgjigjur detyrimisht qytetar të zhvillojnë një fushatë inkurajuese për gratë, që ato ta ndjekin të drejtën e tyre për mundësi të barabarta dhe marrje të përgjegjësive në vendimmarrje. Ajo ka thënë se diskursi përçmues publik ndaj grave që mbizotëron mendësinë tonë dhe kategorizimi i grave si klasë e nënshtruar ndaj superioritetit mashkullor, mbesin shtytësit dominantë për hezitimin e grave të demonstrojnë potencialin e vet dhe kontribuojnë në mënyrë

meritore në të gjitha sferat shoqërore dhe politike. "Gratë nuk guxojnë të bëhen lajm vetëm kur ato dhunohen e abuzohen, ndërsa marginalizohen në të gjitha kontributet e tjera. Kjo qasje publike duhet të marrë fund dhe do t'i japim fund! Gjatë vizitave nëpër komuna, në takimet me gratë e degëve tona, por edhe në takimet spontane me gratë e tjera kam takuar gra dhe vajza të zonjat të profileve të ndryshme. I kam inkurajuar dhe kam kërkuar nga to që, pavarësisht prej barrierave të ngritura padrejtësisht, të mos ngurrojnë për asnjë moment të kalojnë pengesat me aftësitë që zotërojnë dhe me përkushtimin e hekurt të grave - për të ndarë përgjegjësi të barabarta dhe ndikuar në formësimin shoqëror e politik", ka thënë deputetja Deliu.

Ajo shpreson që praktika e nisur nga Partia Demokratike dhe Departamenti për Politika Gjimore të ndiqet edhe nga subjektet e tjera në mënyrë që



ta rrisim fushatën dhe përforcojnë besimin e grave në

ushtrimin e të drejtave dhe ngjitjen e tyre meritorë në

nivelet më të larta vendimmarrëse.

Me bartje të maskës fillon viti i ri shkollor



Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj dhe ministri Shëndetësisë, Armend Zëmaj, kanë bërë me dije të dielën se gjithçka është bërë gati sa i përket fillimit të vitit shkollor 2020/2021. Në një konferencë të përbashkët për media, është theksuar nevoja e bashkëpunimit të të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin mësimor, në mënyrë që të kemi një vit të mbarë shkollor, i cili këtë vit po fillon në kushte të pandemisë Covid-19

Prindërve.

Likaj ka thënë se të gjitha vendimet janë marrë në bashkëpunim, të cilët edhe i ka falënderuar për kontributin e tyre në këtë situatë. Ministri Likaj ka thënë se vendimi për fillimin e vitit të ri shkollor nuk ka qenë aspak i lehtë, por ka theksuar se kthimi i nxënësve në shkolla përbën interes të lartë shtetëror, ndërsa ka falënderuar edhe partnerët zhvillimorë dhe donatorët që u janë përgjigjur nevojave të MASH-it për organizimin e vitit të ri shkollor.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zëmaj, ka theksuar rëndësinë që ka hapja e shkollave dhe bashkëpunimi i të gjithë aktorëve në menaxhimin e situatës, ndërsa ka thënë se MSH-ja do të jetë shumë strikt në vlerësimin e masave, respektimin e udhëzuesve e protokolleve për ta ngritur disiplinën dhe për ta ruajtur shëndetin e fëmijëve, mësimdhënësve dhe të

IKShPK-ja: Do të kemi prioritet shëndetin e fëmijëve

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) përmes një postimi në faqen e vet zyrtare në "Facebook" ka uruar nxënësit dhe mësimdhënësit për vitin e ri shkollor 2020/2021. IKShPK-ja ka theksuar se është në mbikëqyrje të vazhduar të situatës epidemiologjike, ku në veçanti ka prioritet shëndetin e fëmijëve. "Instituti Kombëtar u uron të gjithë nxënësve dhe mësimdhënësve vitin e ri shkollor 2020/2021, duke rekomanduar zbatimin e

rregullave të reja në shkollë për ruajtjen e shëndetit. Instituti Kombëtar është në mbikëqyrje të vazhduar të situatës epidemiologjike, në veçanti prioritet e ka shëndetin e fëmijëve. Çdo shkollë do ta përcjellë shëndetin e çdo nxënësi përmes Task Forcës së saj dhe Task Forcës komunale duke bërë të mundur identifikimin në kohë reale. Çdo rast i dyshimtë i sëmundjes të fëmijët do të hulumtohet dhe gjurmohet menjëherë", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, ka thënë se rikthimi nën kontroll i situatës epidemiologjike në vend, është një ndër parakushtet për organizimin e jetës në shkollë, ndërsa theksoi rëndësinë e respektimit të tri rregullave themelore: mbajtja e maskës, distancës dhe higjienës.

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, u shpreh se angazhimi i përbashkët i të gjitha institucioneve relevante, përfshirë ato të arsimit dhe shëndetësisë, po jep rezultate dhe nga ajo çfarë është parë në terren, tashmë shkollat e Kosovës janë të gatshme për fillimin e mësimi më 14 shtator. Ndërsa përfaqësuesja e Këshillit

të Prindërve, Hadije Zëqaku, ka ftuar prindërit, nxënësit, mësimdhënësit dhe gjithë faktorët e tjerë që janë të përfshirë në shkollë që ta japin kontributin e tyre, në mënyrë që procesi mësimor të ecë mbarë. Më 14 shtator fillon viti i ri shkollor 2020/2021, i cili do të nisë në dy faza. Faza e parë është paraparë të fillojë më 14 shtator në institucionet parashkollore, klasat 1, 2, 3, 6, edhe klasat 10 në shkolla. Edhe klasa 4-5 do të fillojë sipas skenarit A, mësim të kombinuar ose prani në shkollë. Ndërsa më 21 shtator do të fillojnë mësimin klasat 7, 8, 9, 11 dhe 12. Këto klasa do ta fillojnë mësimin më 21 shtator si mësim i kombinuar me prani dy ditë në shkollë dhe tri ditë mësim në distancë.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ministri i Shëndetësisë, Armend Zëmaj, drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj dhe përfaqësuesja e Këshillit të Prindërve të Kosovës, Hadije Zëqaku, kanë uruar të dielën nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.

Në një konferencë të përbashkët për media, është theksuar nevoja e bashkëpunimit të të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin mësimor, në mënyrë që të kemi një vit të mbarë shkollor, i cili këtë vit po fillon në kushte të pandemisë Covid-19.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka folur rreth

përgatitjeve që janë bërë për fillimin e vitit shkollor, i cili do të bëhet në dy faza. Ai ka theksuar se Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka qenë në bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, por edhe me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës dhe Këshillin e

Thaçi uron nxënësit dhe mësimdhënësit, kërkon nga ta t'i respektojnë rregullat e pandemisë

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka uruar për fillimin e vitit të ri shkollor nxënësit dhe mësimdhënësit, duke iu kërkuar që t'i respektojnë rregullat e reja të shkollës dhe klasës që për qëllim kanë ruajtjen e shëndetit të tyre në këtë kohë pandemie. "Ua uroj fillimin e vitit të ri shkollor", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Mungesa e rrymës largon inv

Problemi me furnizim stabil me energji elektrike në Kosovë është theksuar në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit për Klimën e Investimeve të publikuar më 9 shtator. Sipas këtij raporti, Kosova ka potencial për të tërhequr investime të huaja direkte, por një nga problemet që pengon ardhjen e investitorëve të huaj në Kosovë është edhe furnizimi jo i besueshëm me energji


PRISHTINË, 13 SHTATOR - Burim Piraj, pronar i industrisë së mishit "Meka", përballet në vazhdimësi me reduktim të energjisë elektrike. Mungesa stabile me energji elektrike, thotë ai, po i shkakton humbje të mëdha materiale në biznesin e tij. "Ka ndërprerje kohë pas kohe me energji elektrike të planifikuara, por edhe pa planifikim. Ndërprerja e energjisë elektrike shkakton probleme të mëdha pasi që e ndërpret procesin e prodhimit, pastaj makineritë derisa të futen në prodhim humbet kohë dhe shkakton humbje materiale. Nga viti 1999 deri më tani kemi investuar aq shumë për të pasur energji sa do të mund të punësonim edhe 50 punëtorë të rinj. Mungesa e këtij produkti është një prej shkaqeve që e ka pamundësuar edhe punësimin", ka thënë Piraj për "Radion Evropa e Lirë". Problemi me furnizim stabil me energji elektrike në Kosovë është theksuar edhe në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit për Klimën e Investimeve të publikuar më 9 shtator. Sipas këtij raporti, Kosova ka potencial për të tërhequr investime të huaja direkte, por një nga problemet që pengon ardhjen e investitorëve të huaj në Kosovë është furnizimi jo i besueshëm i energjisë.

Investimet e huaja në Kosovë ndër vite kanë shënuar rënie edhe sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës. Në vitin e kaluar vlera e investimeve të huaja në Kosovë ka qenë 265 milionë euro.

KEDS-i: Furnizimi me energji elektrike është stabil

Përgjegjës në Kosovë për furnizimin me energji elektrike është operatori për furnizim me energji (KESCO) dhe ai për shpërndarje të energjisë (KEDS).

Zëdhënësi i Distribucionit të Furnizimit me Energji Elektrike, Viktor Buzhala, duke mos dashur ta komentojë raportin e DASH-it, thotë se ka furnizim stabil me energji elektrike në vend dhe ndërprerjet mund të jenë vetëm në raste të caktuara kur ka ndonjë prishje në rrjet dhe kur duhet të bëhen renovime. "Gjendja e furnizimit me energji elektrike është mjaft stabile. Tani e sa vite KEDS nuk ka aplikuar reduktime për asnjë konsumator. Furnizimi vazhdon pa ndërprerje. Ne kemi trashëguar një rrejt në gjendje mjaft të vjetruar, por ky rrjet është përmirësuar. Ka përparime të theksuara. Ato janë cekur edhe në raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore. Vetëm në dy



raste mund të ketë ndërprerje të energjisë për shkak të faktorëve atmosferikë dhe kur ne intervenojmë për të përmirësuar atë rrjet, pra kur bëhen investime", ka pohuar Buzhala, duke shtuar se i kanë prioritet bizneset sa i përket furnizimit stabil me energji elektrike. Buzhala ka shtuar se KEDS-i në vitet e fundit ka investuar në rrjetin energjetik deri në 150 milionë euro.

Investime vetjake për energji elektrike

Për t'iu ikur problemeve të mungesës së energjisë elektrike, kompania "Pestova", e cila merret me përpunimin dhe prodhimin e patates, në vitin 2008 kishte investuar rreth 250 mijë euro për të ndërtuar një largpërçues. Pronari i kësaj kompanie, Bedri Kosumi, ka thënë për "Radion

Evropë e Lirë" se ky investim është bërë për t'iu ikur humbjeve që kishte kompania nga ndërprerjet e energjisë elektrike. "Aty ku nuk ka energji elektrike nuk ka kurrfarë ekonomie. Fatkeqësisht Kosova është ballafaquar me këtë problem dhe po vazhdon të përballet. Deri në vitin 2008 kemi pasur aq shumë probleme, pastaj me investimet tona kemi ndërtuar një largpërçues, i cili ka një gjatësi 8 kilometra dhe

Turizmi në Shqipëri, 91 milionë euro të ardhura për gjashtë muaj

TIRANË, 13 SHTATOR - Të ardhurat nga turizmi në Shqipëri shënuan vlerën 91 milionë euro në gjashtëmuajorin e parë të vitit. Sipas të dhënave të publikuara nga Banka e Shqipërisë, në gjashtëmuajorin e parë të vitit bilanci i udhëtimeve që matë diferencën mes shpenzimeve të të huajve në Shqipëri dhe shpenzimeve të shqiptarëve jashtë vendit shënoi vlerë pozitive, ndonëse në rënie krahasuar me një vit më parë, për shkak të situatës

Covid-19.

Banka e Shqipërisë ka njoftuar se të huajt shpenzuan 63 milionë euro në tremujorin e dytë, ose 87 për qind më pak se në të njëjtën periudhë vitin e kaluar dhe shqiptarët, në udhëtimet e tyre jashtë, shpenzuan 65 milionë euro, ose 85 për qind më pak se në 2019-n.

Referuar të dhënave të INSTAT-it, numri i shqiptarëve që dolën nga vendi në gjashtëmuajorin e parë të 2020-s është 1.380.308,

duke rënë 48 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në gjashtëmuajorin e parë 2020 është 781.894, duke rënë me 63.4 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Në vitin 2019 bilanci i udhëtimeve arriti vlerën 500 milionë euro, të huajt shpenzuan rreth 2 miliardë euro në udhëtimet në Shqipëri, ndërsa shqiptarët harxhuan jashtë rreth 1.5 miliard euro.



Investitorët e huaj nga Kosova



kemi bërë një zgjidhje të mirë me furnizim të energjisë. Në vitin 2008 kemi investuar rreth 240 mijë euro, ndërsa në vitin e kaluar (2019) janë investuar në këtë largpërçues edhe 100 mijë euro”, ka treguar Kosumi. Sipas një hulumtimi të Odës Ekonomike të Kosovës të bërë në vitin 2018, thuhet se për një vit sektori privat në Kosovë shpenzoi afër 580 milionë euro në blerjen e gjeneratorëve për energji elektrike.

Shteti ta sigurojë energjinë pa ndërprerje për biznesin

Përfaqësues të komunitetit të biznesit në Kosovë thonë se pasiguria me furnizim me energji elektrike është një nga problemet që po i përcjell bizneset në Kosovë.

Kryetari i Odës së Afarizmit në Kosovë, Skënder Krasniqi, ka deklaruar për “Radion Evropa e Lirë” se mungon një strategji nga autoritetet. Kjo strategji, sipas tij, do të duhej të krijonte zonat ku biznesi ta ketë tërë infrastrukturën e nevojshme, përfshirë edhe energjinë elektrike. “Mungesa e kësaj strategjie bën që bizneset të investojnë në ato vende ku infrastruktura e energjisë nuk është në nivelin e duhur. Komunitat në Kosovë u japin leje bizneseve në zona të caktuara t’i ndërtojnë fabrikat, ndërkohë që nuk ua sigurojnë infrastrukturën

e nevojshme. Furnizimi me energji elektrike ndër vite është përmirësuar, por që vazhdon të ketë ndërprerje në disa raste edhe pa paralajmërime, duke dëmtuar biznesin”, është shprehur Krasniqi.

Arsye kryesore e mungesës së këtij produkti në Kosovë vazhdimisht theksohet vjetërsia e termocentraleve në Kosovë. Termocentrali “Kosova A” daton që nga vitet e ’60, kurse termocentrali “Kosova B” nga vitet ’80.

Kosova tani e sa vite ka një projekt për ndërtimin e termocentralit të ri “Kosova e Re” me kapacitet 500 megavatë, projekt ky i cili ishte konsideruar se do ta shkarkonte Kosovën nga problemet me energji elektrike. Por, si i tillë, ky projekt mund të mos realizohet fare, pasi kompania amerikane Contour Global, e cila ishte përzgjedhur nga qeveria për ndërtimin e termocentralit, është tërhequr tanimë nga plani për ndërtimin e termocentralit. Kompania “Contour Global” në mars të këtij viti është tërhequr nga planet për ndërtimin e termocentralit, për arsye se kompania nuk e ka ndërmend të ndërtojë projekte me thëngjill në të ardhmen, po ashtu janë përmendur edhe ndryshimet politike që kanë ndodhur në Kosovë, duke shtuar se ish-kryeministri Albin Kurti e kishte kundërshtuar publikisht projektin.

Zeka: Kosova duhet të insistojë që përfitimet më të mëdha nga marrëveshja për Ujmanin t’i ketë për vete

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Mini-shengeni ballkanik ka qenë një nga pikat e marrëveshjes së 4 shtatorit e nënshkruar në ShBA, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pavarësisht se në fillim kjo iniciativë ishte kundërshtuar në Kosovë, përfshirë edhe LDK-në dhe Avdullah Hotin, i cili në cilësinë e kryeministrit më 4 shtator e nënshkroi këtë marrëveshje. Por, për Arian Zekën nga Oda Ekonomike Amerikane, mbështetja e kësaj ideje nga ShBA-ja ka bërë që Kosova të ndryshojë qëndrim sa i përket mini-shengenit.

Ai në një prononcim për “Ekonomia Online” ka thënë se për këtë nismë kur është prezantuar fillimisht ka pasur pak informacione. “Kur është prezantuar si ide nga dy kryeministrit e shteteve të Ballkanit Perëndimor, ka pasur shumë pak informata sa i përket

kësaj nisme dhe qëllimeve konkrete që synoheshin të arriheshin me krijimin e një zone të re të bashkëpunimit ekonomik, ose një zone të unifikuar të bashkëpunimit ekonomik. Përfshirja e ShBA-së dhe promovimi i kësaj ideje nga ana e tyre, megjithatë i ka dhënë një dimension të ri kësaj ideje, gjë që besoj se ka ndikuar që edhe Kosova të jetë më e hapur ndaj idesë së përfshirjes në të”, ka thënë Zeka.

Ai ka thënë se mini-shengeni do ta mundësojë heqjen e barrierave të lëvizjes së lirë të mallrave dhe njerëzve. “Zona, si e tillë, do ta mundësojë promovimin e atyre që njihen si katër liri: Liria e lëvizjes së mallrave, njerëzve, shërbimeve dhe kapitalit, gjë që e ngre pastaj konceptin për tregti të lirë CEFTA në një nivel krejt tjetër”, ka thënë Zeka.



Se roli i ShBA-së ka qenë përcaktues që Kosova ta pranojë mini-shengenin, e ka thënë edhe vetë kryeministri Avdullah Hoti.

Ai ka deklaruar se mini-shengenin e ka pranuar pasi e ka

kërkuar ShBA-ja.

Pikë tjetër e marrëveshjes në Uashington ka qenë edhe marrëveshja për Ujmanin. E, sipas Zekës, pas kryerjes së fizibilitetit nga ana e Departamentit të Energjisë së

ShBA-së, Kosova duhet ta shfrytëzojë, që në negociatat e mëtejme të insistojë që përfitimet më të mëdha t’i ketë ajo. “Ekzistojnë konventa ndërkombëtare për menaxhimin e ujërave ashtu siç ekzistojnë konventa dhe traktate ndërkombëtare për menaxhimin e aseteve të cilat shtrihen në territoret e dy e më tepër shteteve. Mundësinë e kryerjes së fizibilitetit nga ana e Departamentit të Energjisë të ShBA-së, Kosova duhet ta shfrytëzojë ashtu që pastaj në negociatat e mëtejme të insistojë që përfitimet më të mëdha të vilen nga ana e Kosovës ashtu siç shtrihet ky aset”, ka thënë Zeka. Marrëveshja e karakterit ekonomik e nënshkruar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në Uashington, parasheh edhe investime në infrastrukturën hekurudhore.

Qazim Qeska zgjedhet kryetar i Degës së PDK-së në Rahovec

RAHOVEC, 13 SHTATOR (ER) - Me vota unanime, kryesia e Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Rahovec, ka zgjedhur për kryetar të ri Qazim Qeskën. Procesi i cili u zhvillua në prani të deputetit, njëkohësisht sekretarit për diasporë, Elmi Reçica dhe sekretarit elektorale Betim Gjoshi, u zhvillua me korrektësi maksimale dhe frymë të lartë demokratike.

Qazim Qeska është një ndër aktivistët e vjetër të PDK-së i cili me vite ka kontribuar për

forcimin e strukturave të partisë. Ai do të pasojë ish-kryetarin e deritanishëm, Idriz Vehapin.

Pas zgjedhjes së tij si kryetar i kësaj dege, ai ka falënderuar anëtarët e kryesisë për besimin dhe ish-kryetarin Vehapi për punën e madhe që kanë bërë ndër vite në të mirë të qytetarëve të Rahovecit. “Është nder i posaçëm që të zgjidhem kryetar i kësaj dege. I falënderoj të gjithë anëtarët e kryesisë për besimin që kanë treguar për mua. Ky do të jetë një motiv

shtesë që të mos ndalemi asnjëherë deri në realizimin e objektivave që do t'i kemi si strukturë dhe si parti”, ka thënë Qeska.

Partia Demokratike e Kosovës me besimin e plotë në udhëheqjen e re të kryetarit Qeska, falënderon përzemësisht për punën e madhe ish-kryetarin e deritanishëm të kësaj dege, Idriz Vehapi, i cili, për shkak të angazhimeve të reja universitare, ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit.



Penda në Lupç të Poshtëm të Podujevës, drejt finalizimit



PODUJEVË, 13 SHTATOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, bashkë me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, Vezir Januzi, vizituan punimet

në ndërtimin e pendës për ujitjen e tokave bujqësore në fshatin Lupç i Poshtëm. Nën kryetari Rudari u shpreh i lumtur që po përmbushin zotimet e dhëna për kultivuesit e këtij fshati dhe në këtë

mënyrë po e lehtësojnë punën e tyre dhe po ndikojnë në rritjen e produktivitetit në kulturat bujqësore. Ndërsa drejtori Januzi tha se një pendë e tillë së shpejti do të ndërtohet edhe në fshatin Bajçinë.

Gati në përfundim nënkalimet për vetura te “Plus Marketi” dhe në Varosh

FERIZAJ, 13 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka bërë me dije se janë gati në përfundim nënkalimet për vetura te “Plus Marketi” dhe në Varosh. “Nënkalimet për vetura te Plus Marketi dhe në Varosh janë shembujt sesi me energji të pashtershme, punë ditë e natë, të pakompromis në cilësinë e punimeve, realizohen vepra

madhore infrastrukturore”, ka thënë Aliu gjatë inspektimit të punëve. “Inspektova këto dy nënkalime që kanë arritur kulmin e punimeve në prag të përfundimit, për t'i dhënë frymë sa më parë qarkullimit rrugor në qendrën e qytetit dhe për t'ua mundësuar qytetarëve infrastrukturën që i mungoi për dekada me radhë”, ka deklaruar kryetari Aliu.



Komiteti i emergjencave në Gjilan vazhdon angazhimin kundër Covid-19

Gjilan, 12 shtator (ER) - Komiteti i emergjencave për parandalimin e virusit Covid-19, në mbledhjen e mbajtur, të udhëhequr nga nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, ka thënë se nga mostrat e testuara në 10-ditëshin e fundit ka pak raste pozitive me Covid-19 dhe numër më të madh të të shëruarve që është gjendje shpresuese. “Ka rënie të rasteve pozitive në mostrat e dhjetë ditëve të fundit, ndërsa për fat të mirë numri i pacientëve të shëruar është gjithnjë e më i madh. Sot në rezultatet e fundit nga 46 mostra janë vetëm tri raste pozitive dhe katër raste të shëruara plotësisht. Kjo nuk do të thotë se ne duhet të jemi të qetë, por edhe

më tutje në bashkëpunim me të gjitha institucionet në nivelin lokal dhe atë regional, do ta vazhdojmë respektimin e masave mbrojtëse falë edhe përkrahjes që kemi nga sektori privat i biznesit dhe kultura e lartë qytetare për respektimin e rekomandimeve të shtetit”, ka thënë, nënkryetari Ismajli.

Një lajm i mirë është edhe gatishmëria maksimale e stafit mjekësor për t'i përcjellë në aspektin shëndetësor nxënësit dhe mësimdhënësit, në mënyrë që procesi mësimor të vazhdojë në bazë të planifikimit deri në stabilizimin e plotë të gjendjes me virusin. “Mjekët në dy nivelet e organizimit të shëndetësisë,



emergjencat civile, Policia e Kosovës, zjarrfikësit dhe të gjitha institucionet publike, janë të angazhuar maksimalisht për mbështetjen e mbarëvajtjes së procesit të mësimit nëpër shkollat e Gjilanit”, ka thënë nënkryetari

në fjalën e tij.

Në bazë të statistikave që ka bërë publike Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës, konfirmohet se Komuna e Gjilanit në përballjen me Covid-19 nga data 13 mars e deri më sot ka gjithsej

936 raste pozitive, prej tyre të shëruar plotësisht janë 777 pacient, 41 kanë humbur jetën, ndërsa raste aktive janë 116 pacientë, prej tyre 27 të hospitalizuar dhe me gjendje shëndetësore stabile.

Në kujtim të Sulejman Gashit, gazetarit dhe misionarit të shtetit të Kosovës në Amerikë



Shkruan: Nuhi BYTYÇI

Lajmi për ndarjen nga jeta të intelektualit, gazetarit të përmasave ndërkombëtare, kolegut dhe mikut tonë të dashur Sulejman Gashit, na ka tronditur rëndë të gjithë ne kolegëve, por edhe mbarë opinionin shqiptar. Ai iku në botën tjetër pa u përshëndetur me ne, duke na lënë pa buzëqeshjen e tij të sinqertë, pa raportet dhe pa intervistat profesionale dhe gjithnjë me mesazh të qartë për të ardhmen e popullit tonë. Sylja përherë, edhe në kohë të vështira, kur nuk shihej fare drita në tunelin e gjatë, përmes punës së tij prej gazetari të aftë profesionalisht përçonte mesazhin e optimizmit për lirinë dhe perspektivën e ndritur të popullit të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi.

Kam pasur rastin dhe nderin që ta njoh në fund të viteve '80, kur Sulejman Gashi u pranua gazetar në Televizionin e Prishtinës. Gjatë kësaj periudhe kemi bashkëpunuar me qëllim të informimit sa më objektiv të opinionit lidhur me zhvillimet e atëhershme shumë dramatike në Kosovën, që synonin lirinë dhe demokracinë. Ishte koha kur populli, sidomos rinia, punësoria dhe intelektualët sapo kishin filluar që të zgjohen dhe të vetëdijesohen edhe më shumë në aspektin kombëtar, kishin filluar procese të reja, kishte dalë alternativa shqiptare dhe përfundimisht edhe populli i Kosovës i kishte dhënë goditjen e fundit komunizmit jugosllav, një sistemi që kishte bllokuar popullin shqiptar të Kosovës në rrugëtimin e tij drejt lirisë e pavarësisë. Në këtë periudhë gazetari Sulejman Gashi bashkë me brezin e ri të gazetarëve të Televizionit të Prishtinës, por duke bashkëpunuar ngushtë me kolegët më me përvojë të këtij mediumi të vetëm televiziv në Kosovë, të cilët e kishim thyer censurën komuniste, kemi arritur që TVP-në nga një medium i kontrolluar plotësisht, ta shndërrojmë në televizion të hapur dhe të besueshëm në shërbim të publikut dhe të interesave të popullit shqiptar të Kosovës. Do të vijmë pastaj shumë ngjarje të rëndësishme historike për Kosovën, nga të cilat do të raportojmë bashkë me Sylën dhe

kolegët e tjerë të Televizionit të Prishtinës.

Mbaj mend, kur para 2 korrikut të vitit 1990, në mbledhjen e redaksisë së politikës së brendshme të TV të Prishtinës, udhëhequr nga redaktori Muhamet Mjeku, e bëmë planin e detajuar të raportimit nga mbledhja e Kuvendit të Kosovës, i caktuar detyrat konkrete për secilin gazetar. Në atë mbledhje Sulejmani, pasi që e njihje shkëlqyeshëm gjuhën angleze, mori për sipër që të zhvillojë intervista me përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare, që kishin paralajmëruar përcjelljen e kësaj mbledhje. Dhe, pikërisht më 2 korrik 1990, kur delegatët shqiptarë e të tjerë u penguan nga milicia serbe që të hyjnë në sallën solemne të Kuvendit të Kosovës, para dyerve të Kuvendit të Kosovës ishin edhe avokatja e njohur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në botë, zonja Eva Brendli dhe me përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë. Sylja me këtë rast zhvilloi intervistat me ta në mënyrë profesionale dhe dha kontribut konkret përmes prezantimit të sugjerimeve dashamirëse të përfaqësuesve ndërkombëtarë, që kishin dhënë për delegatët e Kuvendit të Kosovës. Opinioni tonë sigurisht se i kujtohet mesazhi dhe sugjerimi i Eva Brendlit, që rrodhi nga intervista që zhvilloi kolegu Sulejman Gashi: "nuk është me rëndësi që mbledhja të mbahet vetëm në sallë, ajo mund të mbahet edhe para dyerve dhe diku tjetër, por me rëndësi është që në mbledhje të ketë kuorum dhe vendimet të merren me shumicë votash". Kështu edhe ndodhi. Pasi që delegatët shqiptarë dhe të tjerë nuk u lejuan të hyjnë në sallë, ata me shumicë votash, me votat e 111 delegatëve miratuan Deklaratën e njohur kushtetuese, sipas të cilës Kosova nga kjo datë është njësi e barabartë në kuadër të ish-federatës së atëhershme të Jugosllavisë. Intervistat e Sylës dhe intervistat që i zhvillova unë dhe kolegët e tjerë, u transmetuan pa censurë në Ditarin qendror të Televizionit të Prishtinës dhe kështu arritëm që edhe ne të bëhemi pjesë e kësaj ngjarje historike për Kosovën. Deklarata kushtetuese siç dihet pat jehonë të jashtëzakonshme edhe në opinionin ndërkombëtar, duke dëshmuar se populli shqiptar i Kosovës po hyn në një etapë të re të sfidave në rrugëtimin drejt pavarësisë nga regjimi okupues serb.

Pas mbylljes së Televizionit të Prishtinës, si shumë kolegët të

tjerë, edhe Sulejman Gashi u detyrua që të largohet përkohësisht nga Kosova dhe të punojë në gazetari në Shtetet e Bashkuara të Amerikës deri në qershor të vitit 1999, kur Kosova u çlirua përfundimisht. Ai u kthye në Kosovë përsëri si gazetar dhe ishte shumë aktiv me intervistat e tij me personalitetet më të larta ndërkombëtare dhe të institucioneve të Kosovës së re, të zhvilluara në Radiotelevizionin e Kosovës.

Me hapjen e Radiotelevizionit publik të Kosovës, u shpall edhe një konkurs publik për gazetarë. Me që Programi satelitor, redaksia për Kosovën, pjesë e së cilës isha edhe unë dhe pasi që kishte përfunduar misionin e vet me sukses, vendosa që të aplikoj për të punuar në RTK. Duhej që t'i nënshtrohem testit me shkrim.



Në komisionin për pranim të gazetarëve ishte edhe Sulejman Gashi bashkë me Avni Spahiun. Ndonëse kisha përvojë në gazetari dhe në redakturë, kjo ishte një sfidë e re për mua, pasi që konkurrenca ishte shumë e madhe dhe numri i atyre që duhej pranuar ishte i kufizuar. Mirëpo, falë përkushtimit profesional, arrita që ta kaloj me sukses edhe këtë sfidë dhe për pranimin tim, si kam kuptuar më vonë, rol të madh kishte luajtur edhe vlerësimi pozitiv i Sulejman Gashit për mua dhe profesionalizmin e dëshmuar në kohë të vështira.


Pas angazhimit të përhershëm në RTK kemi pasur rast që të bashkëpunojmë ngushtë me Sylën, që të konsultohemi për disa tema dhe emisione që ishin me interes për opinionin dhe gjithëherë kemi ardhur në përfundim se në rrethanat e Kosovës së lirë, shteti i pavarur e demokratik, rol të jashtëzakonshëm ka edhe informimi i paanshëm, objektiv e profesional. Sylja për shkak të familjes, shkollimit të fëmijëve të tij, të cilët i donte shumë, u detyrua që të kthehet sërish në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

dhe nga atje të raportojë për shikuesit e Radiotelevizionit publik të Kosovës lidhur me zhvillimet në Departamentin Amerikan të Shtetit, në Shtëpinë e Bardhë, në Kongres, në Senat, në Pentagon, në OKB dhe në institucionet e tjera amerikane dhe ndërkombëtare lidhur me Kosovën dhe shqiptarët në përgjithësi. Në këtë mënyrë, Sulejman Gashi vërtetë ishte jo vetëm gazetar, por edhe misionar i fuqishëm në paraqitjen dinjitoze të shtetit të ri të Kosovës para institucioneve kredibile amerikane dhe ndërkombëtare. Raportimet e Sylës dhe intervistat përmbajtjesore me zyrtarët e lartë të administratës amerikane dhe të Kombeve të Bashkuara përherë shprehnin optimizmin për mbështetjen e fuqishme nga shteti mik dhe më i fuqishëm në

interesante, na bënë që ta kalojmë bashkë në një atmosferë tejet të këndshme edhe për kolegët e ALBTV në Nju-Jork, familjen Dreshaj dhe Jahjaga, të cilët na shoqëronin në darkë.

Kthehem në Kosovë, duke lënë kolegët e mi në Amerikë. Mirëpo, në mars të atij viti – 2013 në Amerikë shkon për vizitë zyrtare biri im, Arianiti, në krye të një delegacioni të drejtorëve të komunikimit publik të Qeverisë së Republikës së Kosovës në kuadër të programit "International Visitor Leadership Program" organizuar nga Departamenti i Shtetit i ShBA-së. Me këtë rast, Arianiti gjatë kësaj vizite takohet me kolegun tim Sulejman Gashin, i cili ishte ngarkuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan që ta shoqërojë delegacionin nga Kosova në të gjitha takimet në institucionet kryesore amerikane në Uashington dhe në shtetin e Karolinës së Veriut. Arianiti kur u kthye nga kjo vizitë më rrëfeu me entuziazëm për mbresat që i kishin lënë aftësitë e jashtëzakonshme intelektuale e politike të Sylës, para së gjithash, figura e tij prej njeriu e personaliteti të vërtetë dhe unik. Në shenjë kujdesi e respekti ndaj meje, Sylja kishte blerë një kollare elegante dhe në foljen e saj kishte dërguar edhe një letër të vogël, që mban datën e 5 marsit 2013, me një tekst shumë domethënës për mua dhe familje time, ku mes tjerash shkruante: "Përshëndetje Nuhi, të uroj shëndet dhe suksese në punën tënde të dalluar. Dua të të them se Ryva dhe ti kishit një djalë shembullor. Arianiti jo vetëm që ishte mburrja dhe krenaria juaj këtyre ditëve në Amerikë, por ishte edhe krenaria e Kosovës". Vlerësimin e Sylës e çmova shumë për faktin se ishte kujtuar që në mënyrë të veçantë dhe civilizuese ta shprehte mendimin për birin e shokut të tij. Këtë letër e kam ruajtur në arkivin tim dhe e kam lexuar disa herë me emocione edhe pasi kam marrë lajmin e hidhur, tejet të rëndë për ndarjen nga jeta të kolegut, mikut tim shumë të çmuar Sulejman Gashit.

Vërtetë mungesa e Sulejman Gashit është humbje e pakompensueshme, jo vetëm për familjen, por për Kosovën dhe veçmas për gazetarinë shqiptare. Vepra dhe kontributi i tij do të përkujtohen gjithmonë, si shembull i një intelektualit të mençur, vizionarit dhe misionarit të shquar që vazhdimisht ka punuar në afirmimin e çështjes shqiptare në arenën ndërkombëtare. Lamtumirë miku im i shtrenjtë, Sulejman Gashi!



Mbi 'misterin' e autorësisë së poemës 'Kënga e Sprasme e Ballës'

NGA PROF. MATTEO MANDALÀ

Para disa vitesh u dha lajmi (shih *Shëjzat*, series nova, nr. 3-4, 2016, f. 172-196) i gjetjes së një dorëshkrimi të pabotuar autograf të Gavril Darës të Riut me titull autorial <Poesie inedite. Frammenti - 1854>. Dorëshkrimi ruhej nga një trashëgimtare e drejtpërdrejtë e Gavril Darës, profesoresha Marina Spinedi, e cila ia dhuroi atë Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të Universitetit të Palermos, që nga ana e vet ia dorëzoi arkivit të pasur të Laboratorit të Albanologjisë të Departamentit të Kulturave dhe Shoqërive [Culture e Società]. Profesoreshës Spinedi i detyrohem edhe për morinë e të dhënave të frytshme që na lejuan të rindërtonim në mënyrë më të plotë profilin biografik të katragjyshit të saj të famshëm, si edhe të njohim më më fund portretin dhe fytyrën e tij, falë dy fotografive të ruajtura në familje, njërën prej të cilave kemi nderin ta botojmë për të parën herë për lexuesit e *ExLibris*.

Dorëshkrimi në fjalë, që përmban një version të parë të

poemës *Kënga e sprasme e Ballës*, ka një rëndësi vendimtare për zgjidhjen përfundimtare të problemeve të vjetra filologjike mbi gjenezën dhe autorësinë e kësaj kryevepre të letërsisë romantike shqipe, si edhe për rindërtimin e plotë të historisë së shkrimit të saj. Mbi këtë çështje u ndalëm në paragrafin e fundit të hyrjes së botimit kritik të vitit 2007 (Gabriele Dara junior, *Kënga e sprasme e Ballës*, Edizione critica a cura di Matteo Mandalà, Palazzo Adriano), ku komentua strukturën gjenetike (shih *stemma codicum*) të traditës drejtshkrimore dhe të shtypur të kësaj vepre. Me atë rast e lamë qëllimisht mënjanë shqyrtimin e fazës që i paraprin shkrimit të dorëshkrimit, d.m.th. të dorëshkrimit zanafilor që nuk kemi gjetur () dhe që nga pikëpamja tekniko-filologjike mund ta quajmë faza "parahistorike". Këtë fazë Gavril Dara te *parathënia* e tij e kishte përshkruar në një mënyrë të tillë që shumë studiuesve, përfshirë shkruesin e këtyre radhëve, u ishte dukur jo krejt e vërtetë, ose e ndikuar nga miti Osianik. Përjashtim bënte studiuesja ruse Agnia Desnickaja, e cila në vitin 1989, duke hedhur poshtë hipotezën

se pretendimet e Darës ishin "fund e krye një trillim", i përdori ato me largpamësi për të hedhur një "vështrim në laboratorin letrar të familjes së Darenjvet".

Kështu u arrit në identifikimin

e tri fazave të veçanta të hartimit të poemës që përkojnë me kontributin e tre autorëve të ndryshëm:

a) përpjekja e parë për shkrimin e bërthamës së poemës u krye nga Gavril Dara Plaku,

gjyshi i poetit, i cili, sipas të nipit, ishte i pari që mbledhi *Këngët e Pleqërisë*. Mes letrave të Gavril Darës Plakut, i biri Andrea, d.m.th. i ati i Gavrilit të Ri, «pas Vajeve të Nik Petës dhe Pal Golemit gjeti një këngë tjetër që në dorëshkrim mbante titullin *Kënga e sprasme e Ballës*. Ishin vargje që i prekën zemrën sepse përmbanin një rrëfim të plotë e të përkryer në të gjitha pjesët, më mirë se *Këngët e Kostandinit dhe Garentinës*». Dokumentet e zbuluara në fondin *Albansk Samling* pranë Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagës konfirmojnë plotësisht veprimtarinë e mbledhjes së këngëve popullore nga Gavril Dara Plaku, i cili që ndër të parët që i kushtoi vëmendje folklorit arbëresh në epokën pararomantike.

b) Sipas Gavrilit të Ri, i ati Andrea, pas zbulimit të materialeve të Gavril Darës Plakut, ia hyri shkrimit të një vepre, i shtyrë nga fakti se «konstatoi që këto vargje ishin fragmente pak a shumë të arrira; duke lexuar ai kuptoi se mungonin shumë pjesë: në fakt dorëshkrimi përmbante vetëm gjashtëdhjetë vargje në pjesën e parë, po aq në pjesën e dytë e diçka më shumë në të tretën». Pasi lexoi shënimin e të atit që e



identifikonte Ballën me figurën që «edhe sot mund të shihet e pikturuar në portretin që ruhet në Kishën e Shën Marisë së Hireve, me ngjyra të ndesura, me hundën përpjetë, me përkrenare të kuqe dhe me një majë të praruar mbi të, siç është zakoni i luftëtarëve tanë», Andrea «zuri të endej lart e poshtë, a thua se kish dalë për gjah, duke pyetur pleqtë dhe plakat nëse i dinin këngët e Ballës; ca këtu e ca atje mblodhi gojë më gojë pjesën më të madhe që mungonte në shkrimet e të atit dhe i shtoi ato. Kështu mori formë *Kënga e sprasme e Ballës* dhe do të thosha se u zhvillua në të gjitha pjesët e saj, dhe paçka se ende mungon ndonjë copëz aty-këtu, dëmi është i lehtë, sepse me mendjen tonë mund t'i mbushim mangësitë». Në të vërtetë teksti i hartuar nga Andrea përbëhet nga gjithsej 280 vargje (*Albansk Samling*, Theca.II.17, fash. VIII (A-3) në të cilat emri i heroit të poemës është *Dufë*.


c) Përpjekja e fundit për të përfunduar poemën u krye nga Gavrili i Ri: «Unë që mbërrita i treti dhe i fundit kur tashmë gjindja e moçme nuk ishin më gjallë, pak gjeta dhe pak shtova,

por sa vetëm *Këngën e Zogut* që mësova kur isha i vogël. Pastaj kur lexova *Këngën e Ballës* m'u duk e lindur nga mendja që krijoi këngët e tjera dhe se përshtatet vetvetiu në vendin ku unë e futa. Unë mendoj se as im gjysh, as im atë nuk e njihnin këtë këngë, sepse po ta kishin njohur, nuk do ta kishin lënë pa shkruar, sikurse shkruan dhe m'i lanë amanet këngët e tjera».

Tri faktet që na jep Dara janë mbajtur, siç e thamë më lart, si mistifikime letrare, dhe autor i vërtetë i poemës deri më sot është konsideruar vetëm Gavrili i Ri. Mirëpo hulumtimet tona pranë fondit *Albansk Samling* kanë nxjerrë në dritë dokumente në dorëshkrim, që jo vetëm konfirmuan në pjesën më të madhe deklaratat e Darës, por na detyruan të rishihnim rrënjësisht hipotezat e derisotme. Natyrisht nuk është vendi këtu të trajtojmë fill e përpe këtë çështje që e shtjelluam te *Parathënia* e botimit kritik të vitit 2007 dhe që te botimi i ri në proces e sipër do të gjejmë vendin e duhur. Tash për tash po themi se është jashtë çdo dyshimi fakti që Dara përdori disa "të dhëna" të vërteta për të bindur lexuesin se zanafilla e

veprës së tij ishte në fakt krijim mbarë popullor, përcjellë gojë më gojë brez pas brezi derisa i gjyshi dhe i ati vendosën ta mblidhnin. Dhe dorëshkrimi i sapozbuluar vërteton katërçipërisht çka asokohe shtruum si hipotezë të mundshme filologjike.


Versioni i poemës që përmban dorëshkrimi i gjetur jo vetëm që konfirmon plotësisht hipotezën që parashtruum në vitin 2007, por dëshmon jashtë çdo dyshimi kalimin e versionit të pjesshëm të pabotuar që i atribuohet Andrea Darës në versionin që duke filluar prej dorëshkrimi do të karakterizojë emrin e personazhit kryesor që shfaqet në titull. Ishte vërtet Gavrili i Ri, ai që ndryshoi emrin e heroit, duke fshirë emrin *Dufë* që kishte vënë Andrea dhe duke e zëvendësuar atë me *Balla*. Kjo duket qartë nga faqet dorëshkrim që po riprodhojmë këtu (shih fl. 59r), ku ndryshimi i emrit bëhet në të gjitha rastet kur ai shfaqet qoftë në versionin shqip (fl. 59r, 59v, 60r, 56v), qoftë në versionin e pjesshëm italisht në vargje njëmbëdhjetërokoëshe (fl. 20r, 21r). Veç kësaj, fakti se në fl. 56v rreshti 11, emri <Bal>lexohet qartë,



dëshmon se ndreqjet e emrit tjetër *Dufë* u kryen më pas, kur thujse kishte përfunduar së shkruari poema në dorë të parë. Një shënim meriton transkriptimi i saktë i emrit të protagonistit. Në të gjitha botimet e kryera pas botimit të vitit 1906 ka mbizotëruar forma <Bala> me një lexim të gabuar të germës <l> nga ana e botuesve. Këtë gabim e vuri re së pari Aleksandër Xhuvani në vitin 1927 kur e transkriptoi titullin e poemës "Kënga e Sprasme e Ballës", duke i dhënë grafemës <l> vlerën fonetike [ll].

Bazuar në të dhënat e përkryera më lart si edhe të fakteve që rindërtuam në vitin 2007 dhe në dritën e të dhënave të dorëshkrimit të sapogjetur, mund të davaritim përfundimisht dyshimet e derisotme dhe të mbërrijmë në përfundimin e mëposhtëm: Nëse nga njëra anë Gavrili Darës i duhet njohur doemos autorësia e poemës në formën që na është përcjellë nga tradita dorëshkrimore dhe ajo e botuar, nga ana tjetër duhet t'i njohim të atit të Gavrilit, pra Andreas, meritën e konceptimit fillestar të veprës. Nuk ka dyshim se Gavrili i Ri, paçka se përmendi ngjarje të vërteta dhe persona realë, e rindërtoi në mënyrë krejt arbitrare gjenezën e kësaj poeme. Megjithatë ky mistifikim nuk u shpik prej tij. Më shumë se nga miti i Osianit ai u ndikua nga teoria estetike e "së vërtedukshmes" që përpunoi Alessandro Manzoni, autori më i dashur i Gavrili Darës së Ri qysh nga vitet e rinisë së hershme. Siç dihet, Manzoni mbi bazën e mëtimit se kishte gjetur rastësisht disa dokumente të vjetra, shkroi të parin roman historik me peshë të letërsisë italiane. Manzoni

tha se kishte gjetur në një dorëshkrim të vjetër historinë e dy të rinjve të dashuruar dhe se s'kish bërë gjë tjetër veçse i kishte ndrequr paksa gjuhën. Me fjalë të tjera, historia ishte shkruar prej të tjerëve dhe i përkiste një periudhe të shkuar historike. Ky mistifikim synonte të fshihte autorin, por jo zanafillën historike të rrëfimit. Tek e fundit, nëse e shohim nga pikëpamja kritike, epopeja që na përshkruan Gavrili i ri bazohet në të dhëna historike të dokumentuara që autori i sjell duke cituar historianë të shumtë, e në këto të dhëna mbështetej për të afirmuar njësimin e reales me idealen. Është fjala për një konceptim të ri që rrjedh natyrisht prej frymës romantike, por edhe që dallohet prej asaj fryme, në mos tjetër, nga orvatja për të paraqitur «idealen të lidhur harmonikisht me realen». Ky parim estetik dhe ideologjik përshkon tejendane poemën e Gavrili Darës. Po të prananim sfidën e vështirë të Benedetto Croce-s për të sintetizuar në një formulë kompleksitetin historik të një veprë letrare, të një periudhe ose të një a më shumë autorëve, mund të thoshim se De Rada ka qenë modernizuesi i një letërsie të sapolindur prej vetë penës së tij, ndërsa Gavrili Dara i Riu ka qenë ithtari i tij më besnik që ia doli të njësonte autorin me veprën, aq sa arriti të përvijonte *ante litteram* një nga kanonet e postmodernizmit të ardhshëm. Mirëkuptimi dhe miqësia e sinqertë mes këtyre dy kolosëve të letërsisë romantike shqipe është dëshmia më e mirë e këtij vizioni të përbashkët që ata kishin për letërsinë. Por për këtë duhet të flasim një herë tjetër. /exlibris.al/



E jashtëzakonshme

Furgoni që po i habit të gjithë, duket i rrokullisur, por ai lëviz normal si veturat e tjera

Kemi pasur rastin të shohim kur në aksidente trafiku veturat të rrokullisen dhe të përfundojnë me rrota lart, por jo edhe që në këtë pozitë një veturë të lëviz lirshëm. Një furgon GMC i prodhuar në vitin 1985, shihet në një video amatore se si në të futen disa persona dhe largohen sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Pronari i furgonit kishte bërë një modifikim duke i vendosur rrotat në pjesën e sipërme dhe kur ajo lëvizte dukej qartë se i ka dy palë rrotë dhe se një palë shërbenin thjesht për "atraksion".



FOTO E DITES



Pamje nga lart e bukurive të Shalës së Bajgorës

BARSOLETA E DITËS



Një grua donte të vriste veten dhe të hidhej nga ballkoni. Kështu burri i saj telefonon policinë dhe i thotë:
 - Alo, alo policia! Ndhimë! Gruaja po tenton të hidhet nga ballkoni.
 - Nëse do të vetëvritet, mos e lejo ta bëjë.
 - Po ka ngecur te dera e ballkonit.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E rrallë

Diamanti i përsosur 102 karat del në ankand

Një prej diamanteve më të rrallë në botë pritet të dalë në ankand muajin e ardhshëm dhe pritet ta kapë vlerën e 12-30 milionë dollarëve. Shtëpia e Ankandeve Sotheby's ka njoftuar se xhevahiri 102.39 karat, me një shkëlqim të përsosur, është diamanti i dytë më i madh oval i këtij lloji që del në shitje. Më i madhi, një diamant 118.28 karat, u shit me çmimin rekord prej 30.8 milionë dollarësh, në Hong-Kong në vitin 2013.



DASHI
Dita e fundit e javës do të jetë për të argëtuar dhe gjëja më e mirë që mund të bëni është të shkoni në një festë.



DEMI
Do të keni një udhëtim në det, një festë ditëlindjeje, një lojë futbollit me miq të cilët keni shumë kohë që i njihni.



BINJAKËT
Ndikimet dhe yjet e këtyre ditëve të fundit mund të kenë provuar kreativitetin tuaj, shoqërinë, optimizmin dhe pikërisht për këtë arsye.



GAFORRJA
Një seri ngjarjesh ju vë përpara një realiteti krejt ndryshe nga ai i imagjinuar dhe i shpresuar.



LUANI
Gjëja e rëndësishme tani është që qëndrueshmëria në përfundimin e projekteve që keni filluar të zhvilloni prej kohësh.



VIRGJËRËSHA
Nuk do të jetë një nga ato ditët e paharrueshme që ju pëlqen të vendosni në librin tuaj të albumeve, por gjithsesi dita do të kalojë mirë.



PESHORJA
Sidoqoftë, do të merrni një zhgënjim nga kthesa e një shoku, ku do të kishit vënë dorën tuaj në zjarr për të.



AKREPI
Ju pret një ditë në të cilën gjithçka ecën normalisht, por kjo është pikërisht ajo për të cilën pendoheni.



SHIGJETARI
Do të jenë para të shpenzuara vetëm për kënaqësinë e personave të tjerë. Nëse aktiviteti juaj profesional zhvillohet në sektorë që lidhen me ushqimin, bujqësinë, ose financat, kjo ditë do të jetë në anën tuaj.



BRICJAPI
Mbani sytë hapur në vendin e punës, dikush mund të përpiqet t'ju turpërojë duke ju vendosur qëllimisht në një situatë të vështirë.



UJORI
Asgjë serioze, megjithatë arrini të nxirrni të mirat edhe nga gjërat e vogla. Përfshini atë në grupin tuaj shoqëror.



PESHQIT
Yjet po ju shikojnë me mirësi. Një ëndërr e vjetër në sirtar, e parë në dritën e realitetit aktual, mund të fillojë të marrë formë.

“Dy zemra”, publikohet kënga e re e Norës dhe Butrintit



Dy këngëtarët e famshëm shqiptarë, Butrint Imeri dhe Nora Istrefi, të dielën kanë publikuar bashkëpunimin e tyre të parë. “Dy zemra” titullohet kënga e re e dyshes, të cilën e kanë kompletuar mjaft mirë edhe nga ana vizuale. Artistët vijnë me një paraqitje të veçantë skenike, teksa nëna e një vajze ka mahnitur me dukjen

ekstravagante. Tekstin e ka shkruar vetë artisti Imeri në bashkëpunim me Gjikon, teksa për producimin është përkujdesur BigBang, në tërësi Redbox Entertainment. Kënga ritmike tanimë gjendet edhe në platformën e AVD Digital në YouTube dhe reagimet e fansave të tyre ishin të menjëhershme dhe shumë pozitive.

Rita bëhet nostalgjike, kështu argëtohej mbrëmjeve jashtë para pandemisë



Pandemia Covid-19 e ka prishur rregullin e jetës së të gjithëve, ndërsa presim ditë më të mira. Këngëtarja Rita Ora përmes rrjeteve sociale i kujton me nostalgji mbrëmjet para pandemisë, ku dilte dhe argëtohej bashkë me miq.

“Mbrëmjet e të premtëve para pandemisë”, ka shkruar ajo sipër një fotografie, të cilën e ndau me miliona ndjekësit e saj në “Instagram”. Rita Ora muajt e fundit është komentuar shumë për romancën e re me, Romain Gavras.




Çiljeta publikon bashkëpunimin e ri

‘Zemër’ titullohet projekti më i ri muzikor i Çiljeta Xhilagës dhe këngëtarit Ernest Zeka, i njohur ndryshe si Estto. Muzikën dhe tekstin e ka punuar vetë Estto, kurse videoklipin kompania

‘RedBox’. Projekti në fjalë flet në përgjithësi për dashurinë dhe dyshja kanë vendosur që përmes këtij videoklipi të na sjellin edhe pamjet e bukura të trevave tona shqiptare.

Conor McGregor arrestohet në Francë



Ish-kampioni i luftimit stil UFC, Conor McGregor, ka rënë së fundmi në telashe me autoritetet në Francë pasi është arrestuar për “tentativë sulmi seksual dhe ekzibicion seksual” në ishullin turistik të Korsikës. Sportisti i famshëm u arrestua dhe u mor në

pyetje nga policia dhe më pas u lirua, teksa përfaqësuesit e tij thanë se ka mohuar me forcë akuzat e ngritura. Lajmi u publikua fillimisht nga rrjeti AFP Sport, që tha se McGregor është arrestuar për “ekspozim të turpshëm”, por më pas u publikua njoftimi i prokurorisë vendëse.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ademi: 29 vjet më parë nisi rrugëtimi i futbollit të pavarur

Futbolli i Kosovës më 13 shtator të vitit 1991 filloi rrugëtimin e pavarur me ndeshjen në mes të Flamurtarit dhe Prishtinës. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka kujtuar këtë datë historike, duke thënë se më 13 shtator filloi etapa e re për futbollin, që ishte degë e rëndësishme e zhvillimit të republikës dhe që iu kundërvu suksesshëm okupuesit serb



"Epoka e re"

PRISHTINE, 13 SHTATOR - 29 vjet më parë ka filluar një etapë e re për futbollin e Kosovës, pasi më 13 shtator të vitit 1991 filloi rrugëtimi i futbollit të pavarur me ndeshjen në mes të Flamurtarit dhe Prishtinës. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka kujtuar këtë datë historike, duke thënë se më 13 shtator filloi etapa e re për futbollin, që ishte degë e rëndësishme e zhvillimit të Republikës dhe që iu kundërvu suksesshëm okupuesit serb. "Sot është një ditë e rëndësishme për futbollin e Kosovës. 29 vjet më parë nisi rrugëtimi i futbollit të pavarur. Ishte 13 shtatori i vitit 1991 dhe ndeshja Flamurtari - Prishtina kur filloi etapa e re për futbollin tonë, që ishte degë e rëndësishme e zhvillimit të Republikës dhe që iu kundërvu suksesshëm okupuesit serb. Asnjëherë nuk do të harrohen njerëzit vullnetmirë që dhuruan tokat e tyre për t'i shndërruar në fusha futbollit dhe që i dolën krahë kryesisë së parë të Federatës në krye me Agim Bytyqin. Edhe pse në kushte tejet të vështira, nën drejtimin e tij u arrit të bëhet një punë kolosale, të cilën më pas e vazhduan me sukses edhe dy drejtuesit e tjerë të FFK-së, i ndjeri Rexhep Abdullahu dhe Sabri Hashani, gjithmonë duke e zhvilluar futbollin dhe ligat sikurse të ishim të pranuar në UEFA dhe FIFA. Në atë periudhë u krijua edhe ekipi i Kombëtares së Kosovës në krye me

përzgjedhësin e parë Ajet Shoshollin, që zhvilloi disa ndeshje ndër vite", ka thënë Ademi.

Ademi ka kujtuar të gjithë ata që e ndihmuan futbollin e Kosovës duke dhuruar tokat për t'i bërë fushat e improvizuara të futbollit, kurse shumë të tjerë ishin donatorë. Sipas kryetarit aktual të FFK-së, atëbotë futbollin e ndiqte i gjithë populli sepse ishte mbijetesë në kushte okupimi dhe segment i shtetësisë së Kosovës. "Pra, futbollit ynë ishte unik në të gjithë botën ngaqë në një shtet që sapo kishte filluar të formohej po luhej futbollit me të gjitha rregullat e dy institucioneve ndërkombëtare por që, fatkeqësisht, nuk pranoheshin sepse nuk lejohej nga regjimi i atëhershëm. Atëbotë futbollin e ndiqte i gjithë populli sepse ishte mbijetesë në kushte okupimi dhe segment i shtetësisë së Kosovës. Përveç atyre që dhuruan tokat e tyre për t'i improvizuar në fusha futbollit, një pjesë tejet e rëndësishme ishin edhe biznesmenët donatorë, që nuk nguruan t'i ndajnë mjetet e tyre çdo muaj për t'u mundësuar zhvillimi i garave. Solidarizimi në atë kohë ishte i jashtëzakonshëm, ku të gjithë protagonistët e një ndeshje futbollit (lojtarët, trajnerët, gjyqtarët, delegatët dhe zyrtarët e klubeve) punonin vullnetarisht, vetëm që futbollit të zhvillohej, ndonëse një periudhë e tillë zgjati për vite të tëra", ka shtuar ai.

Për gjeneratën e sakrificës, Ademi ka thënë se meriton një respekt të veçantë për faktin se tregoi se si duhet

futbolli dhe si respektohet shteti. "Ajo gjeneratë e futbollistëve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe punëtorëve të tjerë sportivë, meriton respektin maksimal dhe kujdesin e veçantë për sakrificën e bërë, ngaqë futbollit u zhvillua në kushte të jashtëzakonshme, në fusha të improvizuara dhe nën maltretime të shumta të autoriteteve të atëhershme të instalura nga Serbia që kishin pushtuar çdo sferë të jetës në Kosovë. Gjenerata e sakrificës tregoi durim, kulturë dhe dinjitet se si duhet futbollit dhe si respektohet shteti, teksa shumë prej futbollistëve të asaj periudhe ranë në altarin e lirisë në luftë me okupatorin serb. Sot të gjithë ata vlerësohen si heronj të futbollit për sakrificën e bërë", ka thënë Ademi, i cili është shprehur se kjo periudhë e vështirë gjithmonë do të jetë e shënuar me shkronja të arta në historinë e futbollit, sikurse edhe pjesa më e fortë e zinxhirit të vazhdimësisë deri te pranimiti në UEFA e FIFA nën udhëheqjen e legjendës, Fadil Vokrri. "Falënderoj të gjithë ata futbollistë, trajnerë, gjyqtarë, punëtorë sportivë, donatorë e kryetarë klubesh, si dhe kryetarët e federatës dhe anëtarët e saj në vazhdimësi, për punë të artë në kohë të vështira. Gjithmonë do ta kujtojmë këtë periudhë me krenari e përgjegjësi", ka shtuar ai. Në fund, Agim Ademi ka thënë se tash sfidat dhe objektivat janë shumëfish më të mëdha dhe se po punohet që futbollit i Kosovës të dërgohet në nivele sa më të larta, duke vazhduar ta bëjnë popullin krenar me rezultatet dhe arritjet.

SHKURT

Pesë golat e Vikingut i shënuan futbollistët kosovarë

Pesë golat e fitores për skuadrën e Vikingut në ndeshjen e fundit i kanë shënuar futbollistët kosovarë. Vikingu e ka mposhtur të shtunën Kristiansund BK (3-5) në ndeshjen e 17 në kampionatin e Norvegjisë. Veton Berisha dhe Zymer Bytyqi realizuan nga dy gola, kurse me një gol ka kontribuar Yldren Ibrahimaj, kurse për vendësit në listën e shënuesve u regjistruan Amahl Pellegrino me dy gola dhe një tjetër e shënoi Bendik Bye. Vikingu zë vendin e nëntë me 22 pikë, kurse Kristiansund BK pozicionohet e pesta me 27 pikë.

Edhe Tottenhami në garë për Kumbullën

Trajneri Jose Mourinho ka shprehur interesim që ta ketë në skuadër mbrojtësin e Kombëtares së Shqipërisë, Marash Kumbulla, raporton "L'Arena di Verona". Verona kërkon 24 milionë euro për lojtarin shqiptar, i cili është në listën edhe të Juventusit, Interit, Lazios dhe Milanit.

Gashi mposhti me KO bokserin boshnjak

Boksieri shqiptar Senad Gashi ka shkëlqyer në duelin e mbrëmjes së të shtunës ndaj boshnjakut Adnan Redzović. Atleti i rritur në Gjermani i dha fund duelit në raundin e katërt me nokaut. Me këtë fitore Gashi regjistron fitoren e 20-të në boksion profesionist. Aktualisht 30-vjeçari i lindur në Pejë është shqiptari më elitari në boksion e peshave të rënda, duke ecur në gjurmët e atletëve të njohur si Luan Krasniqi dhe Arnold Gjergjaj.

Sileks-Drita, transmetohet në televizionin shtetëror të Maqedonisë

Ndeshja e raundit të dytë eliminator në Ligën e Evropës midis skuadrës së Sileksit dhe Dritës, do të transmetohet në televizionin shtetëror të Maqedonisë, njofton "infOSport.mk". Drejtuesit e televizionit shtetëror dhe skuadra nga Kratova kanë arritur sot marrëveshjen për transmetimin e këtij takimi, që në program është më datë 17 shtator. Ndeshja do të zhvillohet në stadiumin "Todor Proeski" në Shkup me fillim në orën 20:00 dhe do të luhet me dyer të mbyllura pa praninë e publikut për shkak të pandemisë me Covid 19. Kjo ndeshje njëherësh duhet të jetë paralajmërim për atë që na pret në muajin tetor, kur në Shkup në kuadër të ndeshjes gjysmëfinale të Ligës së Kombeve, Maqedonia e Veriut do të mirëpret Kosovën.

Hamiltoni triumfon në Mugello, zhgënjën Ferrari

MUGELLO, 13 SHTATOR - Lewis Hamilton ka fshirë zhgënjimin e Monzas me një fitore të shkëlqyer në Çmimin e Madh të Toskanës, i pari që

zhvillohet në Mugello dhe që është karakterizuar nga aksidente dhe dy amuj të kuq me po aq rinisje të garës. Pas anglezit është renditur

Valteri Bottas, duke kompletuar "dopjetën" e radhës të Mercedesit. Në podium është ngjitur edhe Alexander Albon, i cili ka bërë një garë të

jashtëzakonshme. Tjetër zhgënjim për Ferrarin: Charles Leclerc e ka mbyllur në vendin e tetë, Sebastian Vetteli në të dhjetin.



Muriqi: Dua ta jap më të mirën për Lazion

ROMË, 13 SHTATOR - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, ka zbarkuar të dielën në Romë. Sulmuesi shtatlartë do t'i zhvillojë sot (e hënë) vizitat mjekësore dhe më pas do ta firmosë kontratën pesëvjeçare (2.2 milionë euro rrogë sezonale) me Lazion. 18 milionë euro (+2 milion në formë bonusesh) kushtoi 26-vjeçari nga Prizreni, i cili ishte pjesë e Fenerbahçes sezonin e kaluar. Muriqi foli shkurt rreth aventurës së re në një prononcim për mediat turke përpara nisjes për në kryeqytetin italian. "Jam shumë i përshtatshëm për stilin e lojës së Lazios. Në shumicën e ndeshjeve të sezonit të kaluar kam luajtur me skemën me dy sulmues. Drejtuesit më thanë që kanë nevojë për një sulmues me karakteristikat e mia. Edhe unë i dhashë menjëherë përparesi klubit të Lazios. Objektivat? Në fillim vjen sukcesi kolektiv, më pas ai individual. Shpresoj ta ndihmoj ekipin tim të ri me golat që do të shënoj. Dua të jap më të mirën për Lazion. Në të ardhmen shpresoj të bëhem pjesë e klubeve më të mëdha në botë", ka deklaruar Muriqi.

Lazio ka konfirmuar se Vedat Muriqi do të jetë lojtar i saj. Në faqen zyrtare, Lazio i ka dëshiruar mirëseardhje sulmuesit kosovar që transferohet nga Fenerbahçe. Lazio



e ka paraqitur Muriqin si "sulmues turk". "Vedat Muriqi ka arritur në Romë. Rreth orës 14:20 sulmuesi turk ka aterruar në aeroportin 'Ciampino', i gatshëm për aventurën e re. I lindur në vitin

1994, Muriqi vjen nga Fenerbahçe. Ai do t'u nënshtrohet kontrollimeve të zakonshme mjekësore në klinikën Paideia nesër në mëngjes, para se të bëhet lojtar i ri i Lazios", shkruan në faqen zyrtare të Lazios.

Lakersat pas 10 vjetësh kualifikohen në finale

Orlando, 13 shtator - Los Angeles Lakers siguron, pas 10 vjetësh mungesë, finalen e Konferencës së Perëndimit në NBA. Krejt e lehtë për LeBron Jamesin me shokë, të cilët dominuan në ndeshjen e pestë kundër Houston Rocketsit, duke fituar 119-96 dhe mbyllur serinë 4-1. Tani në finale mund të jetë derbi i shumëpritur kalifornian mes Lakersave dhe Clippersave, me këta të fundit që kryesojnë 3-2 ndaj Nuggetsit që mund t'i mbyllin llogaritë në rast sukcesi, pa qenë nevoja që të luhet sfida e 7-të. Përballja e pestë mes Lakersave dhe Rocketsit nuk pati histori, pasi i vendos që në periodën e parë, me një rezultat të pjesshëm 35-20, raporton "SS". Rockets u përpoq ta shkurtonte diferencën para pushimit të pjesëve, por në periodën e tretë LeBroni me shokë e "vranë" përfundimisht ndeshjen, duke shkuar plus 26 pikë. Në periodën e fundit Rocketsi, thjesht,



priti rënien e sirenës për ta zyrtarizuar eliminimin. Të gjithë basketbollistët titullarë të Lakersave realizuan numër dyshifror pikësh, të udhëhequr nga LeBroni, i cili shënoi 29 pikë, rikuperoi 11 topa dhe dha 7 asistime. 30 pikët e James

Hardenit rezultuan të pamjaftueshme për Houstonin, ndërsa për Russell Westbrook ishte një mbrëmje vërtet për t'u harruar, pasi e mbylli takimin me vetëm 10 pikë, duke mos qenë i saktë në asnjë tentativë për tri.

SHKURT

Morbidelli fiton Grand Prixin e San Marinos

Franco Morbidelli ishte më i shpejti në garën e San Marinos. Në një spektakël të zhvilluar në pistën e San Marinos, ishte Franco Morbidelli ai që në fund siguroi triumfin. Piloti i Yamahas u tregua më i shpejtë duke lënë të gjithë prapa. Garë të mirë pati edhe veterani Valentino Rossi, i cili garën e mbylli në pozitën e katërt. Maverick Vinales, i cili nisej nga pozita e parë në këtë garë, përfundoi vetëm në pozitën e gjashtë. Kujtojmë se garave vazhdon t'iu mungojë kampioni në fuqi, Marc Marquez i Honda.

Mbappe e njofton PSG-në se dëshiron të largohet

Ylli i Francës, Kylian Mbappe, do të largohet nga PSG-ja pas verës së vitit 2021. Kështu raporton prestigjiozja "The Times". Thuhet se kampioni i botës i ka dhënë mundësinë drejtorit të klubit francez që në sezonin e ardhshëm ta transferojë për një shifër të bujshme. Ndërkohë, shumë gjigantë të futbollit si Real Madrid, Liverpool dhe Manchester United e ndjekin prej kohësh Mbappenë, të cilit duket se i ka lënë shije të keqe humbja e trofeut të Ligës së Kampionëve ndaj Bayern Munchenit.

Një lojtar i Benficas dhe tre të Sportingut infektohen me Covid-19

Portieri i Benficas, Mile Svilar, ka rezultuar pozitiv me koronavirus, ka njoftuar nga Lisbona. Po ashtu, edhe tre lojtarë nga rivali lokal, Sportingu, janë infektuar me koronavirus, raporton agjencia "Reuters". Benfica ka konfirmuar se belgu 21-vjeçar Svilar do të mungojë në ndeshjen e rrethit të tretë kualifikues të Ligës së Kampionëve kundër PAOK-ut të martën. Ndërkohë burime për "Reutersin" kanë njoftuar se tre lojtarë të Sportingut të Lisbonës kanë dalë pozitivë me koronavirus. Ata janë pa simptoma dhe janë izoluar.

Miliki arrin marrëveshje personale me Romën

AS Roma raportohet se ka arritur marrëveshje personale me Arkadiusz Milik dhe tani po punon ta gjejë pajtimin me Napolin. Sipas gazetarit italian, Alfredo Pedulla verdukuqet kanë arritur marrëveshje personale me sulmuesin polak të cilit i janë ofruar 5 milionë euro në sezon plus bonuse nga Roma. Klubi kryeqytetas tashmë kërkon ta gjejë pajtimin edhe me skuadrën e Napolit. Milik ka kontratë me Napolin deri më 2021.

Unitedi 'harron' Sanchon, dëshiron Balen

Manchester United e ka larguar vëmendjen nga Jadon Sancho për shkak të çmimit të lartë. Unitedi tash është fokusuar në transferimin e Gareth Bale nga Real Madridi. Uellsiani nuk po gjënjë hapësirë në "Santiago Bernabeu" dhe largimi në këtë afat kalimtar duket i mundshëm.



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:080877
 Datë: 04.09.2020
 Numri i dokumentit: 01094789

C.nr.532/15

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Malsor Kryeziu, me sekretaren juridike të kësaj gjykate Drita Haxhishabani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: 1. Sadije (Bajram) Gashi, e lindur Çuni, nga Gjakova, rr."Lekë Dukagjini" nr.192, Dardani (ish Piskotë), 2. Vesel (Hisni) Gashi, nga Gjakova, rr."Lekë Dukagjini" nr.192, Dardani (ish Piskotë), të cilët i përfaqëson i autorizuari Teki Bokshi, avokat nga Gjakova, kundër të paditurve: 1. Vidosava (Golub) Rashoviq, 2. Milorad (slobodan) Rashoviq dhe 3. Velisha (Shqepan) Rashoviq, ish nga Piskota, tani të shpërngulur në Serbi në adresë të panjohur, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Afrim Radoniqi, avokat nga Gjakova dhe të paditurës 4. Radmila Rashoviq, ish nga Gjakova, tani me adresë të panjohur, për të cilën propozohet që ti caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, me objektin e kontestit për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në paluajtshmeri, vlera e kontestit 3.700 euro, me propozim që të njëjtit të i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, me date 03.09.2020, mori këtë:

AKTVENDIM

I. Të paditurës Radmila Rashoviq, ish nga Gjakova, tani me adresë të pa njohur, të cilit nuk i dihet adresa e saktë, **I CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm Hasasn Pruthi, avokat nga Gjakova.

II. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare, në një nga gazetatat e përditshme ditore si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Arsyetim

Paditësit 1.Sadije (Bajram) Gashi, e lindur Çuni dhe 2. Vesel (Hisni) Gashi që të dy nga Gjakova, rr" Lekë Dukagjini" nr. 192, Dardani, në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurve:1.Vidosava Golub Rashoviq, 2.Milorad Slobodan Rashoviq dhe 3.Velisha Shqepan Radoviq ish nga Piskota-Gjakova.

Numri i lëndës: 2019:080877
 Datë: 04.09.2020
 Numri i dokumentit: 01094789

Gjyqtari gjykues pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka gjetur se të paditurit 1. Vidosava Golub Rashoviq, 2.Milorad Slobodan Rashoviq dhe 3.Velisha Shqepan Radoviq ish nga Piskota-Gjakova, tani janë me adresë të pa njohur dhe se nuk dihet ku është vendosur gjegjësisht se ku jetojnë. Pas plotësimit të kushteve procedurale të paditurve 1,2 dhe 3 gjykata me aktvendimin C.nr.532/15, të dt.15.01.2018, i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm Afrim Radoniqi, nga Gjakova.

Në ndërkohë pas nxjerrjes së ekspertizës gjeodezike dhe pas konstatimit se si bashkëpronar i ngastrave kontestuese evidentohet edhe personi Radmilla Rashoviq, i autorizuar i paditësve ka bërë zgjerimin e padisë edhe ndaj të paditurës Radmila Rashoviq, ish nga Gjakova, për të cilën ka propozuar caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për shkak se nuk e posedon adresën e saktë.

Gjyqtari i çështjes ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil në kuadër të MPB-së, se a ka informacion se e paditura Radmilla Rashoviq, është e regjistruar në Kosovës dhe nëse është e regjistruar të na sigurohet adresa e saktë, mirëpo nga institucioni i lartpërmendur kemi konstatimin se nuk në data bazën e të gjendjes civile nuk ka të shënime për Radmilla Rashoviq.

Gjyqtari pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe duke pasur parasysh se procedura për caktimin e përfaqësuesit ligjor do të zgjatë shumë, e në anën tjetër do të shkaktohen dëme të pa nevojshme palës paditëse e me qëllim të evitimit të pasojave të dëmshme gjykata i caktoi Hasan Pruthi, avokat nga Gjakova-përfaqësues i përkohshëm për të paditurën Radmila Rashoviq, tani me adresë të pa njohur, gjersa ai të paraqitet në këtë gjykatë apo gjersa organi i kujdestarisë të njoftojë se ka caktuar kujdestarin.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimin konfirmim dispozitive të nenit 79.3 pika a) dhe b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Nr.03/L-006, 30 qershor 2008.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
 C.nr.532/15 të datës 03.09.2020

Gjyqtari
 Malsor Kryeziu

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Princi Company" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabriken për seleksionimin, ambalazhimin e plastikës, qelqit, metaleve, asgjësimin- djegien e mbeturinave urbane, gomave te vjetra, vajrave, mbetjeve medicinale e barnave te skaduara ne Harilaq, Fushe Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.10.2020 në ora 10:00 lokacionin Sllatinë në Restorantin ROLLYDAY, në anën e djathtë të rrugës kryesore -autoudha Pejë-Prishtinë, përballë Motelit dhe stacionit të Karburantëve "Ana Benz" afro -15 km para hyrje në Komunën e Fushë Kosovës do të organizohet debat publik nga Kompania "PRENI" Sh.p.Seçishtë, Hani i Elezit, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabriken për seleksionimin, ambalazhimin e plastikës, qelqit, metaleve, asgjësimin- djegien e mbeturinave urbane, gomave te vjetra, vajrave, mbetjeve medicinale e barnave te skaduara ne Harilaq, Fushe Kosovë.

Debati Publik do të organizohet në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

linku i platformës ZOOM
<https://us04web.zoom.us/j/9662771284?pwd=dXgzVW9BalhJS3IKdEVTV1F0NTFvZz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► "Albesi" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330259483.

► Lëshoj banesë me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxehe qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

